



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në :
“Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”,
“Marrëdhënie Publike”

Universiteti European i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Ardita Reçi

2. Dr. Diana Kalaja

Shtator/ 2025

Tabela e përgjithshme për programin e studimit Master Profesional në:

**“Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”,
“Marrëdhënie publike”.**


1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit (Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	MAS Nr. 465 datë 15/08/2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	N/A
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit /2 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024 9 PAE/2 PAK 2024-2025 9 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	2023-2024 2 studentë 2024-2025 3 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” është riorganizim i programit Master Profesional në “Komunikim”, që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Në mbështetje të pikës 4, të nënit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 465, datë 15/08/2023, “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Mastër Profesional në “Komunikim” me profile “Gazetari dhe Mediat e Reja”, “Marrëdhënie Publike Politike”, “Shkrim Krijues”, “Menaxhim Marketingu” dhe “TV-Multimedia”, në Mastër Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Dixhitale”, “Marketing” dhe “Marrëdhënie Publike”, në Universitetin Europian të Tiranës. Programi përfshihet në ciklin e dytë të studimeve dhe kohëzgjatja e tij është 1 vit akademik, i organizuar me 60 kredite ECTS. Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut, njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET, për ofrimin e këtij programi.

Kodi i programit, sipas VKM Nr. 310, datë 11.05.2022, është 71MP388S. Në përfundim të këtij programi studimit lëshohet diplomë “Mastër Profesional” në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing” dhe “Marrëdhënie Publike”, në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në Universitetin Europian të Tiranës.

Programi mbështet misionin e UET për një edukim cilësor dhe forcimin e dijeve të qëndrueshme. Objektivi i programit është përgatitja e specialistëve në fushën e komunikimit dhe mediave digjitale, të cilët janë të aftë të ndërmjetësojnë ndërveprimin e aktorëve të shoqërisë, biznesit, politikës apo sektorit civil me median dhe publikun, duke shërbyer në funksion të prezantimit apo promovimit të produkteve dhe shërbimeve në tregun e mallrave, shërbimeve, hapësirën publike dhe atë digjitale. I organizuar si një kombinim i teorisë me praktikën, programi i studimit mbështetet nga stafi akademik i përgjedor dhe një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mjediset e tjera profesionale në kuadër të praktikave dhe marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit me institucionet dhe bizneset.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për realizimin e vlerësimit të programit të studimit “Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, të Universitetit Evropian të Tiranës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u njoh fillimisht me bazën dokumentare të përcjellë nga institucioni pranë ASCAL. Aty përfshiheshin plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloret e programit të studimit, informacione mbi strukturat mbështetëse, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione për realizimin e praktikave mësimore, marrëveshje dhe projekte në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, udhëzues dhe mjaft evidenca të tjera mbështetëse, të cilat ofronin një pamje të qartë mbi organizimin dhe menaxhimin e programit.

Në datat 24 dhe 25 prill 2025, grupi zhvilloi takime, sipas një agjende të koordinuar nga ekspertja e ASCAL me institucionin, të cilat ishin planifikuar paraprakisht sipas një agjende të detajuar dhe të dakordësuar me institucionin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Dr. Ardita Reçi dhe Dr. Diana Kalaja. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik e ASCAL, Anilda Beqiraj.

Gjatë takimeve në institucion, GVJ bisedoi me personelin akademik, drejtuesit dhe studentët, si edhe përfaqësues të zyrave të ndryshme në UET duke mbledhur informacione të rëndësishme rreth praktikave të mësimdhënies, metodologjive të vlerësimit dhe kriterëve të parashikuara në standardet e formatit të raportit për vlerësimin e jashtëm. Takimet dhanë një informacion plotësues dhe të drejtpërdrejtë mbi ecurinë, rezultatet dhe sfidat me të cilat përballen studentët dhe pedagogët, si dhe mbi eficiencën e metodave të mësimdhënies të aplikuara.

Pas marrjes së dokumentacionit dhe realizimit të takimeve, GVJ analizoi me kujdes gjithë informacionin e grumbulluar, duke i referuar ato në hartimin e një raporti të detajuar. Ky raport përfshin një analizë të gjitha standardeve dhe kriterëve të vlerësimit të programit, duke u siguruar që secili aspekt të jetë vlerësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Raporti paraqet një vështrim të kujdesshëm mbi performancën e programit të studimit dhe ofron një bazë për rekomandimet e mëtejshme, duke u fokusuar në strategjitë për përgatitjen profesionale të studentëve.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 11.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 161/6, datë 11.09.2025. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 17.09.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 161/7, datë 17.09.2025. IAL s ka komente, drafti merr formën e raportit përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Universiteti European i Tiranës, rregullores së programit, Statutit të institucionit, si edhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Programet e studimit të ofruara nga Universiteti European i Tiranës, synojnë konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore të vendit. Deklarata e vizionit të UET thekson “... UET do të punojë e përpaket vazhdimisht për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare ...” Në Planin Strategjik UET 2021-2025 theksohet se edhe prioriteti në fushën e edukimit është “... do të ofrojmë edukimin cilësor duke e pajisur studentin me vlerat, aftësitë profesionale dhe disiplinën intelektuale, në mënyrë që ata të bëjnë një kontribut pozitiv për shoqërinë.” Programet e studimit që ofrohen në UET synojnë forcimin e mëtejshëm të vlerave kulturore akademike dhe të kulturës kombëtare, të përcaktuara këto si në planin strategjik të zhvillimit të institucionit edhe në strategjinë e kërkimit shkencor. <i>Evidenca nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca nr. 3.1 Strategjia e kërkimit shkencor në UET</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, GVJ konstaton se programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional me profile

në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	“Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e komunikimit duke respektuar edhe bazën rregullative të institucionit dhe standardet e cilësisë. Programi respekton Misioni e UET për edukim cilësor të studentëve, si edhe në përmbushje të prioriteteve të detajuara në Planin Strategjik 2021-2025 “ ... për tu ofruar studentëve një eksperiencë akademike të shkëlqyer nëpërmjet dijes metodave dhe teknikave bashkëkohore të mësimdhënies”. Programi i studimit është bazuar në Kartën e Bolonjës si edhe zhvillimet e profesionit të gazetarit dhe të tregut mediatik në tërësi. <i>Evidenca nr. 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca nr. 14.2 Plani mwsimor I programit</i> <i>Evidenca nr. 14. Kurrikula e programit MP “Komunikim dhe Media digjitale</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, GVJ konstaton se programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e komunikimit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen objektivat kryesore të programit të studimit të cilët janë në përputhje me kuadrin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe statutit të tij, duke synuar formimin e specialistëve të komunikimit me njohuri profesionale dhe konceptet e fushës së medias. <i>Evidenca nr. 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca nr. 7 Rregulore e programit tw studmit “MP komunikim dhe media digjitale</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Gjatë studimit të dokumentacionit të përcjellë nga institucioni GVJ konstaton se programi i Ciklit të Dytë Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” është hapur duke pasur parasysh nevoja e tregut dhe programi është formatuar edhe pas studimeve periodike mbi tregun e punës dhe bashkëpunimeve të vazhdueshme me Bordet e Tregut të Punës që ka ndërtuar universiteti. <i>Evidenca nr. 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i>




vendas dhe atë ndërkombëtar.	Evidenca nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025 Evidenca nr. 12.1. Bordi i tregut te punes 2023-2025 Evidenca nr. 12.2. Axbenda Bordi i tregut te punes. Evidenca nr. 12.2. Mbledhje Bordi 2024-2025.			
Konkluzione	GVJ shprehet se UET ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Programi i studimit është ndërtuar në përputhje edhe me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe si edhe tendencat e profesionit të specialistit të medias në tregun vendas.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Departamenti Shkencave Humane dhe Komunikimit, në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, është një ndër fakultetet themeluese të Universitetit Europian të Tiranës. Në themelimin e tij në vitin 2006 UET kishte si njësi kryesore “Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit”. Ndërsa me vendimin e Ministrisë së Arsimit në 2008, fakulteti u riorganizua me emërtimin që mban edhe sot. Fakulteti mbledhë rreth vetes një stafe me përvojë akademike disa vjeçare, me tituj dhe grada shkencore dhe drejtues të disa veprimtarive të mirëfillta kërkimore dhe shkencore. Në vitin aktual të studimit 2024-2025 stafi i Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit ka: 2024-2025 10 PAE/ 2 PAK 2023-2024 9 PAE/ 4 PAK 1 Prof Dr, 2 Prof. As , 2 Dr, 7 Msc 45% e stafit janë me titull shkencor Dr dhe më lart. Ndërsa njësi kryesore, pra Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve

	Liberales ka 50 staff akademik PAE+PAK, në vitin akademik 2024-2025, të ndarë sipas titujve 16 me titullin Prof. Dr. dhe Prof. Asoc. Dr.; 8 me titullin Dr. dhe 26 me Msc ose Dr. në proces. Nga shikimi i CV të personelit akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe stafi i ftuar të japë lëndë specifike, tregohet se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi. Stafi akademik ka eksperiencë akademike dhe përvoja profesionale që më së miri japin njohuritë e duhura për realizimin e këtij programi studimit. <u>Referencë:</u> Evidenca 23. Tabela 1 Evidenca 20. CV e personelit akademik.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësive bazë, departamentit. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel e parë dhe të dytë. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe shpërndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane. Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 19. Syllabuset lëndëve (të specifikuar për secilën lëndë) Evidenca i 20. CV e personelit akademik. Evidenca 6. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Dokumenti 54. Vendim nr.74 dt.21.01.2009 për hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të dytë DND dhe MNP Evidenca 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET” Evidenca i 54.2. Urdhër Nr. 465 dt. 15.08.2023 Për riorganizimin e MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 54.3. VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET” Evidenca 54.4. VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” është në përputhje me fushën akademike e njësisë bazë, departamentit. Përputhja e fushës akademike dhe kërkimore është e qartë si nga syllabuset e lëndëve edhe nga veprimtaritë kërkimore të zhvilluara nga departamenti. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset lëndëve (të specifikuara për secilën lëndë)</i> <i>Evidenca 20. CV e personelit akademik.</i> <i>Evidenca 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse Dokumenti 54. Vendim nr.74 dt.21.01.2009 për hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të dytë DND dhe MNP</i> <i>Evidenca 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”</i> <i>Evidenca 54.2. Urdhër Nr. 465 dt. 15.08.2023 Për riorganizimin e MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 54.3. VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”</i> <i>Evidenca 54.4. VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”</i> <i>Evidenca 43.2 Programi i Madh Kërkimor 2021-2025</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” është tërësisht i përputhur me profilin akademik departamentit/fakultetit dhe të institucionit. <i>Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Studentët që diplomohen në UET kanë një organizim të tyre në Alumni. Ky organizim i mbështetur nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit u krijon atyre mundësinë të kenë kontakte profesionale, pjesëmarrje në aktivitete/konferenca/workshop të cilat pasurojnë njohuritë e studentëve në lidhje me zhvillimet e reja sipas degëve të tyre të studimit. Gjithashtu UET ka të zhvilluar komponentin e lidhjes me tregun e punës dhe organizon pjesëmarrjen e të gjitha

	departamenteve në panaiet work&study. Edhe ndërtimi i Bordeve të tregut janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve dhe përshtatjes sa më mirë të tyre me nevojat e tregut të punës. <i>Evidenca E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>Evidenca 12.3. Poster Panairi i Karrierës 2024.</i>			
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacionin e përcjellë dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve në institucion, vlerëson se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion, Fakulteti dhe Departamenti. UET ka kapacitetet e duhura profesionale, të stafit akademik dhe infrastrukturor për të ofruar këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit në UET bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative. UET ka një bazë rregullatore të detajuar dhe akte që përcaktojnë rolin dhe detyrat funksionale si të departamenteve, dekanatit, etj. Rregullore e UET si edhe Dokumenti “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” janë një themel i qartë në ndarjen e detyrave funksionale dhe mundësitë e bashkëpunimit midis njësive të ndryshme në UET.

	Departamenti në mënyrë periodike bën analizimin e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizimin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor. Gjatë vizitës në UET nga diskutimi me Dekanen e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si edhe diskutimin me stafin e pedagogëve që japin mësim në këtë program, GVJ u informua rreth mbledhjeve mujore që bën Departamenti si për ecurinë e programit apo edhe për progresin e studentëve. Në disa nga këto mbledhje marrin pjesë edhe studentët e programeve të studimit lidhur me tematika të caktuara. Evidenca 5. Rregullore e UET Evidenca 6 F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 12.6. Mbledhje e hapur me studentët Evidenca 38. Analiza e Departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikim. UET ka 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë, e njëkohësisht gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike. UET është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. Një ndër këto programe është edhe Erasmus+, i cili u lejon lëvizshmërinë e studentëve dhe stafit akademik, në universitete të tjera jashtë vendit, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre. Stafit akademik i angazhuar në këtë program dhe që ka kryer shkëmbim në kuadër të Erasmus +, KA1 për vitet akademike 2023-2025. Gjithashtu, fakulteti dhe departamenti kanë qenë dhe janë në proces bashkëpunimi të vazhdueshëm me zyrën e projekteve dhe ndërkombëtarizimit UET gjatë viteve akademike të përmendura si më sipër, për t'u dhënë mundësi studentëve për përfshirje në program. Nga dokumentet e përcjella nga UET jepen të listuara disa nga

	bashkëpunimet themelore të Departamentit për realizimin e programit të studimit. Kështu UET ka marrëveshje të nënshkruara (memorandum bashkëpunimi) brenda dhe jashtë vendit. Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi edhe me organizata të huaja. <i>Evidenca 5. Rregullore e UET</i> <i>Evidenca 32.1. Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.</i> <i>Evidenca 33. Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i> <i>Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	UET ka ngritur Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve me anën e së cilës realizon bashkëpunimin me institucionet homologe universitare dhe kërkimore. Këto bashkëpunime janë edhe në kuadër të projekteve të mëdha ndërkombëtare si Erasmus+, Monet, etj. Marrëveshjet në kuadër të projekteve janë për lehtësimin e mobilitetit si të studentëve ashtu edhe të pedagogëve. Aktualisht Departamenti për këtë program studimi, praktikën mësimore e kë të ndërtuar si në auditor për katër javë dhe pjesën tjetër e ka në institucione të ndryshme. UET ka lidhur marrëveshje me këto institucione për përfshirjen e studentëve të tyre në punë e përditshme si me Euronews Albania, Fundjavë Ndryshe, Albtelekom, etj. <i>Evidenca 2. Statuti i UET</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET</i> <i>Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit hartohet i detajuar, si për marrëveshjet që lidhen me praktikën, marrëveshjet në kuadër të projekteve të huaja në network me universitetet e tjera, për shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu në seksion më vete evidentohen edhe organizmat pjesëmarrësve në panairot e punës. <i>Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>

Konkluzione	<i>UET siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis departamenteve dhe organizmave të ndryshëm brenda institucionit, nëpërmjet ndarjes së detyrave. Gjithashtu, për realizimin e objektivave e procesit mësimor dhe ën shërbim të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, si network me universitetet ndërkombëtare, ashtu edhe për realizmin e praktikave të studentëve në vend dhe për panaiet e punës dhe studimit. Për të gjitha këto marrëveshje institucioni mbi baza vjetore shikon efektivitetin që ato kanë patur te studentët dhe stafi akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe	Programi e studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” të UET është organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuar me kredite sipas legjislacionit në fuqi dhe mbështetur në Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i organizuar në një vit mësimor me 2 semestra dhe total prej 60 ECTS. Sipas rregullores së programit studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” pika 3.1 struktura e programit të studimit ka të

Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	gjithë veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri tek E – ja. i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 ECTS-10%) ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (18 ECTS-30%) iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (18 ECTS-30%) iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (6 ECTS-10%) v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (12 ECTS-20%). Lëndët kanë të gjitha nga 6 ECTS, me përjashtim të punimit të diplomës/ provimit përfundimtar që ka 12 ECTS. Ndarja e lëndëve të programit është në zbatim të të Udhëzimit nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” si edhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” Evidenca 5. Rregullore e UET Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 14. MP Komunikim dhe Media Digjitale Kurrikula
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Sipas rregullores së programit studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale”, pika 3.3 janë të përcaktuar edhe objektivat e programit të studimit: “Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Programi i studimit Master Profesional, synon ta pajisë studentin me: a. Koncepte të aplikuara, të specializuara; b. Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; c. Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative; d. Aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; e. Njohuri teorike bazë të fushës së studimit; f. Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët

fushë të specializuar studimi ose profesionale.	kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; g. Aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës. h. Diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional Këto aftësi të fituara si nga pikëpamja teorike ashtu edhe praktike mundësojnë që studenti të fitojë njohuri në profilet e ndryshme në fushën e komunikimit, edhe digjital. Dokumenti “<i>Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i>” jep gjithashtu “Objektivat strategjikë të programit” të renditur si në përgatitjen e specialistëve të komunikimit dhe dialogut e marrëdhënieve ndërkulturore e ndërkombëtare në përgjithësi, duke përshtatur njohuritë teorike dhe praktike me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet mësimdhënies me pedagogë të aftë, me eksperiencë të gjatë e kontribut në fushën akademike, në bashkëpunim me profesorë të ftuar nga universitetet më të mira duke përdorur metoda interaktive dhe audiovizuale të mësimdhënies për përvetësimin sa më të mirë të njohurive nga ana e studentëve. Sipas këtij dokumenti studentëve u ofrohen edhe mundësi të shkëmbimit të studimeve, jashtë vendit si edhe zhvillimin e kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve, angazhimit të stafit akademik efektiv dhe studentëve, marrëdhëniet e drejtpërdrejta me tregun e punës dhe mundësi për trajnimin e vazhdueshëm profesional. Nga diskutimet në takimet me stafin e departamentit dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, si edhe me studentët pjesëmarrës në takim u theksua objektivi i mësimdhënies si për informacione teorike ashtu edhe njohuritë specifike praktike lidhur me profesionin dhe tendencat e reja në zhvillimin e tij. Kjo ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike u jep mundësi studentëve të punësohen në të gjitha agjencitë e informimit publik zyra shtypi, radio televizion, shtyp i shkruar, media online si edhe shtëpi botuese. Gjithashtu studentët mund të punësohen edhe në organizata të shoqërisë civile, të huaja apo lokale që kanë objekt të punës së tyre median. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14. MP Komunikim dhe Media Digjitale Kurrikula</i>
Kriteri 3. Programi i studimit	Sipas kurrikulës së programit të studimit Master Profesional në

ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	“Komunikim dhe Media Digjitale”, dokumenti <i>MP Komunikim dhe Media Digjitale Kurrikula</i>” praktika mësimore është e organizuar të zhvillohet gjatë semestrit të parë dhe ka 6 ECTS. Kjo praktikë vlerësohet me notë. Provimi i përgjithshëm i formimit/punimi i diplomës ka 12 kredite dhe gjithashtu vlerësohet me notë. Dokumenti “Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar” jep përmbajtjen e këtij provimi diplomimi të ndarë në kontroll të njohurive – 25%, grup pyetjesh analitike 50%, dhe grup pyetjesh alternative, detyre praktike 25%. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.3. Format i Tezës së Provimit Përfundimtar</i> <i>Evidenca 14. MP Komunikim dhe Media Digjitale Kurrikula</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” - kriteri nuk aplikohet
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së	Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” - kriteri nuk aplikohet



paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UET është institucion i arsimit të lartë, institucion jopublik dhe nuk gëzon status të veçantë. Format e organizimit të studimit, pranimi i studentëve dhe financimi në UET janë të rregulluara nga ligjet e MAS dhe rregulloret përkatëse të UET. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip) _struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit, në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në UET e ka mbështetur ndërtimin e këtij program studimi dhe si edhe përmirësimin dhe riorganizmin e tij në programe studimi të ngjashme si nga institucione të arsimit të lartë brenda vendit, ashtu edhe nga përvojat e marra nga universitetet jashtë vendit. Struktura e lëndëve, kurrikula, rezultatet e pritshme të të nxëniet janë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar që së paku 70% e përmbajtjes të jetë e ngjashme dhe e krahasueshme me programet e tjera të studimit të akredituara. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip) _struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale”, me profilet përkatëse është hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse për kodifikimin e programeve të studimit. Kodi i këtij programi sipas VKM 310 datë 11.05.2022 është 73MP0388S. Për sa i përket kodimit të lëndëve, ato janë të dallueshme në syllabuset e tyre që prezantohen çdo fillim viti mësimor.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe	Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” - nuk është program i përbashkët.

programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi e studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale" me profile "Gazetari Digjitale", "Marketing", "Marrëdhënie publike" në UET plotëson standardit. Programi ka një kurrikul të mbështetur në bazën ligjore në fuqi, me lëndët të ndarë sipas kategorive formuese, me praktika dhe provim përfundimtar të vlerësuar si edhe me kodifikim sipas VKM dhe udhëzimeve përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale është i përbërë nga 3 departamente: • Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, • Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve • Departamenti i Arteve të Aplikuara. Për të përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit që është njësia përgjegjëse e programit të studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale" ka angazhuar në mësimdhënie në ciklet e studimeve, personel të kualifikuar në fushën pedagogjike, por edhe në mediat në vend, me titujt të ndryshëm dhe grada shkencore përkatëse

Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për pedagogët sipas gradave shkencore:

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	-	7	2
Prof.Ass.Dr.	5	2	6	1
Dr.	10	3	7	2
MSc.	21	11	20	6
Total	42	16	40	11
Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr			2	
Prof.Ass.Dr	1		1	
Dr	3	1	1	1
MSc	5	3	6	1
Total	9	4	10	2

Programet e studimit janë të strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Përbërja e fakultetit është në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore, mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Staf i është me titujt të ndryshëm dhe gradat shkencore përkatëse, si edhe profesorë me përvojë të gjatë, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar, kryesisht lektorëve nga mediat e veçanta. Vlen të përmendet fakti se Anëtarët e Bordit të Tregut të Punës, në vijimësi kanë mbështetur

	konsolidimin e këtyre programeve për shkak të kërkesave të tregut të punës. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 23.1.Tabela 2</i> <i>Evidenca 23. Tabela 1</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profilet e tij, ka në përbërje të kurikulës edhe praktikën mësimore/profesionale. Ajo është një nga lëndët dhe ka 6 ECTS dhe vlerësohet me notë. Praktike zhvillohet në institucione/media të ndryshme në varësi të profilin dhe bashkëpunimit që UET ka me këto institucione. Mbikëqyrja nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit bëhet si nga pedagogët e ngarkuar me këtë mbikëqyrje ashtu edhe nga personi përgjegjës i kompanisë institucionit i ngarkuar me zhvillimin e praktikës. <i>Evidenca 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)</i> <i>Evidenca 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 32. Tabela 5</i> <i>Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, dhe dokumentacionin e përcjellë, koordinatori i programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profilet e tij UET e ka caktuar me Vendim nr. 500 datë 03.10.2024 Sipas Rregullores së UET mbi funksionimin e Departamentit, Kompetencat kryesore të Përgjegjës të grupit mësimor, krahas përcaktimeve në Statut, janë: - Koordinator i programeve të studimit të ofruara nga Departamenti në nënfushën përkatëse më afër ekspertizës së grupit mësimor, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e kurikulës së programit/eve përkatëse, për të garantuar respektimin e parimeve dhe kritereve të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara, dhe për të siguruar përditësimin e tyre me të rejtat e shkencave përkatëse dhe kërkesat e tregut të punës; - Miraton tezat e provimeve dhe temat e detyrave të kursit;



	c. Përgjegjës për përcaktimin e materialeve të nevojshme bibliografike dhe informatike që nevojiten për mësimdhënie në lëndët përkatëse dhe për Bibliotekën digjitale për fushën e tij; d. Bashkëpunon ngushtë edhe me Qendrat e Kërkimit/grupet e kërkimit në fushën specifike; e. Shqyrton hartimin e programeve të lëndëve, përpara miratimit përfundimtar nga përgjegjësi i departamentit. Ai ka të drejtë t'u kërkojë titullarëve të lëndëve të reflektojnë ndryshimet e nevojshme, në përgjigje të kërkesave të standardeve dhe kritereve të miratuara në UET. f. Kontrollon përputhshmërinë e temave të diplomës me aksin kërkimor të pedagogut udhëheqës. g. Përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së zhvillimit të praktikave profesionale, mban dhe përditëson databazën me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale të studentëve; h. Harton raport periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional, i cili analizohet në mbledhjen e departamentit përkatës." <i>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i> <i>Evidenca 36. Emërimet e koordinatorëve dhe përgjegjësve të grupeve mësimore.</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, si edhe nga kontaktet dhe informacioni i mbledhur gjatë vizitës në mjediset e tij, GVJ vlerëson se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për këtë program studimi i përmbushin plotësisht kriteret e këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit si edhe Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale disponojnë një bazë të mirë dokumentacioni mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike”. Dokumentacioni i paraqitur, përfshirë planin mësimor dhe syllabuset, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Përmes sistemit elektronik të komunikimit LMS e gjithë baza dokumentare e këtij programi si edhe informacionet dhe dokumentacioni për programin mund të aksesohet nga personeli akademik. Gjithashtu, studentët e regjistruar në këtë program, mund ta marrin informacionin nëpërmjet këtij sistemi elektronik të komunikimit, koordinatorëve të fakultetit si edhe sekretarisë mësimore. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Digital marketing and social media si shembull i Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i këtij programi studimi ofron informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, duke përfshirë emërtimin e lëndës, semestrin kur ajo zhvillohet, ngarkesën mësimore të orëve në auditor dhe jashtë tij, si ndarjen në kredite ECTS. Programi ka 60 ECTS. Ndarja e lëndëve brenda dy semestrave ndjek strukturën e logjike të krijimit të bazës së nevojshme për kalimin e njohurive dhe rritjen graduale profesionale të studentëve. Edhe ndërthurja e njohurive teorike dhe atyre praktike ndjek të njëjtin logjikë në formimin profesional të studentëve. <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Digital marketing and social media si shembull i Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,	Informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve merren nga studentët në disa forma. Ai ofrohet në rregulloren e këtij programi studimi. Po ashtu ai jepet edhe në broshurat promovuese për programin, me fillimin e vitit akademik. Procedurat e pranimit publikohen në të gjitha mjetet e informimit.

transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” lejon edhe transferimin e studimeve nga/në programe të tjera, me ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedurat e transferimeve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse të programit të studimit. Gjithashtu dokumenti specifik “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin” përcakton procedurën që me fillimin e kërkesës së studentit, ngritjen e “Komisioni i Njohjes i Departamentit”, para aplikimi, regjistrimi paraprak, dhe deri te njohja e programit dhe regjistrimi përfundimtar. Ky dokument jep te veçanta procedurën për transferime edhe në nivelet e ndryshme të studimit. <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 28. D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit ka të detajuara syllabuset e lëndëve, që janë pjesë integrale e planit mësimor. Informacioni i përfshirë në këto syllabuse, si në drejtim të formës dhe përmbajtjes përputhet me aktet ligjore duke vënë në pah konceptet themelore dhe objektivat e secilës lëndë. Struktura e syllabuseve detajon temat dhe çështjet kryesore, së bashku me literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, si edhe format e mësimdhënies. Kjo qasje siguron që studentët të kenë akses në informacionin e nevojshëm për përgatitjen e tyre akademike. Metodat e kontrollit të njohurive janë gjithashtu të detajuara në syllabuse, duke ofruar transparencë dhe orientim për studentët në lidhje me procesin e vlerësimit. <i>Evidenca 19.1. A-III-5-1 Format i Syllabusit (shqip_anglisht)</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Digital marketing and social media si shembull i Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profilet përkatëse është në përmirësim e përditësim të vazhdueshëm. Departamenti në fillim të çdo viti akademik kërkon rishikimin e syllabuseve të lëndëve përpara fillimit të procesit mësimor. Përditësimit e syllabuseve lidhen me plotësimin e literaturës dhe përditësimin e saj, si edhe

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	me tema të reja që mund të shtohen për ti shërbyer më shumë nevojave të tregut të punës, përditësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të studentëve etj. Përmirësimet e syllabuseve duhet të miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore (GMK) dhe më pas arkivohen në departament. Programi i studimit është riorganizuar nga Master Profesional në Komunikim, duke shtuar komponenten e Medias Digjitale për të qenë më afër nevojave të tregut dhe zhvillimeve të medias në vend. <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Digital marketing and social media si shembull i Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Programi ka të përcaktuar qartë syllabuset për të gjitha lëndët, planin mësimor të ndarë sipas lëndëve dhe kategorive si edhe metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit. UET ka të përcaktuar qartë edhe politikën e transferimit të studimeve. Programi i studimit është përditësuar dhe riorganizuar duke shtuar edhe komponentin e mediave digjitale. Programi përmbush plotësisht kriteret e parashikuara në këtë standard.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, por edhe në informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” të UET ka një strukturë të

aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	mirëpërcaktuar që thellon njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të studentëve, duke i përgatitur ata për studime të mëtejshme dhe/ose për tregun e punës. Përmbajtja e programit garanton thithjen e kompetencave dhe aftësim për tregun e punës. Përzgjedhja e lëndëve është bërë e tillë që përshtatet me objektivat e programit, ashtu edhe me kërkesat e tregut. Kjo qasje garanton që studentët të fitojnë njohuri dhe praktikë specifike, të cilat janë të nevojshme për të filluar një karrierë profesionale. Praktika profesionale, e cila realizohet në semestrin e parë ndërlidhet edhe me nevojën e krijimit të njohurive për të formësuar diplomimin nëpërmjet provimit final/punimin e diplomës. Ndarja në profilet specifike, nëpërmjet lëndëve që janë me zgjedhje, u jep studentëve njohuritë e nevojshme profesionale. Edhe ndërtimi i syllabuseve të lëndëve, e vendos theksin tek aplikimi praktik i njohurive. <i>Evidenca 19.1. A-III-5-1 Format i Syllabusit (shqip_anglisht)</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, planin mësimor dhe përmbajtjen e syllabuseve, shpërndarja e lëndëve midis semestrit të parë dhe të dytë mbështet arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Lëndët janë të tilla që japin formimin karakterizues dhe pastaj disiplinat profesionale. Praktika profesionale është e ndarë në 8 orë në auditor, 22 orë punë individuale të studentit dhe 120 orë në terren pranë një institucioni. Praktika profesionale është e vendosur në program në semestrin e parë duke i paraprirë kështu edhe semestrin të dytë ku studentët kanë përzgjedhur se cilën tematikë do të ndjekin dhe të mund të realizojnë suksesshëm punimin e diplomës. <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti	Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe jep njohuri,

teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Kjo është sidomos e qartë me përzgjedhjet me profilet specifike. Ndërtimi i programit është bazuar në planin strategjik për këtë program dhe objektivat formuese të tij. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Syllabuset e lëndëve të renditura në referenca 19</i> <i>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe punësim në përfundim të studimeve. i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 ECTS-10%) ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (18 ECTS-30%) iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (18 ECTS-30%) iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (6 ECTS-10%) v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (12 ECTS-20%). <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e	UET ka të ndërtuar edhe procedurën e punës për kontrollin e programeve të lëndëve dhe përmbajtjen e syllabuseve. Kjo është edhe pjesë e metodologjisë së punës së Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profilet përkatëse është në

tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	përmirësim e përditësim të vazhdueshëm. Departamenti në fillim të çdo viti akademik kërkon rishikimin e syllabuseve të lëndëve përpara fillimit të procesit mësimor. Përditësimi e syllabuseve lidhen me plotësimin e literaturës dhe përditësimin e saj, si edhe me tema të reja që mund të shtohen për ti shërbyer më shumë nevojave të tregut të punës, përditësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të studentëve etj. Përmirësimet e syllabuseve duhet të miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore (GMK) dhe më pas arkivohen në departament. Literatura bazë e parë në syllabuse është e shtëpive botuese të cilat kanë emër ndërkombëtar për botimet universtare. Sikurse u shprehën edhe pedagogët e këtij programi studimi, në dhënien e literaturës kryesore ndiqet edhe parimi i marrjes së literaturave më të mira që janë specifike për subjektin e veçantë. Një pjesë e mirë e literaturës është edhe e përkthyer dhe publikuar nga “UET press” të tilla si “Dinamika e komunikimit masiv” - J.R. Doninick, “Hyrja ne komunikimin politik” Brian Mc. Nair. Këto janë tekste shumë të rëndësishme mësimore që përdoren gjerësisht. Ndonëse ato janë botime më të largëta se 5 vite, ato përsëri janë themeli i mësimi të profesionit, për të vendosur bazat e nevojshme dhe aftësitë profesionale. Literatura plotësohet me materialet të përditësuar, fashikujt dhe pjesë të shkëputura për tema të veçanta. Pedagogët e këtij programi studimi theksojnë se ka lëndë të tilla si Praktikum i shkrimit krijues ku librat janë Thomas S. Kane – “Si të shkruajmë shqip” 2010 – përkthyer M. Nishku, XH. Lloshi) apo “Si të shkruajmë shqip” 2008, i Gjovalin Shkurtaç, që ndonëse janë libra të dhjete viteve më parë, vazhdojnë të jenë literatura e vetme në treg për këto lëndë. <i>Evidenca 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset</i> <i>Evidenca 37.1. Raporti i vlerësimit te programeve te lendeve</i> <i>Evidenca 38. Analiza e departamentit pergjegjes mbi arritjen e objektivave formuese te programit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Departamenti përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies për të maksimizuar nxënien e njohurive dhe përditësimin e tyre. Programi përmban elementët e nevojshëm dhe bashkon teorinë me praktikën në lëndët e formimit të karakterizues dhe ato të specialitetit. Praktikant synojnë të profilizojnë studentët para diplomimit, duke ofruar përvojë të rëndësishme në terren. Kjo qasje bën që studentët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e



	nevojshme duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 37.1. Raporti i vleresimit të programeve të lendeve</i> <i>Evidenca 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike” ka të reflektuar kërkesat e tregut/biznesit/industrisë mediatike. Ky program i siguron studentëve të kenë përparësi në aspektet profesionale dhe të zënë vend shpejt në media pas daljes nga studimet. Njësia bazë/kryesore mbajnë kontakte të rregullta me tregun e punës përmes lektorëve të ftuar dhe marrëveshjeve me institucione publike e private. Gjatë kohës së studimit, studentët janë të angazhuar në media të ndryshme apo në aktivitetet e organizuar nga universiteti, ndërsa me përfundimin e programit të studimit, ata kanë aftësitë e nevojshme praktike për tu punësuar në media, kompani/organizata private dhe publike, institucione, etj. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> Evidenca plotësuese pas vizitës: - Studimi i tregut të punës			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit në Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” është në përputhje të plotë me kërkesat e standardit, duke reflektuar objektivat formuese. Evidencat e përcjella nga institucioni dhe informacioni i marrë gjatë vizitës së realizuar konfirmojnë se programet synojnë zhvillimin e kompetencave që përputhen me kërkesat e tregut të punës, duke garantuar një arsim cilësor dhe të orientuar drejt përgatitjes profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe

organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike”, njësia bazë/kryesore konsulton edhe me aktorë të tjerë dhe veçanërisht me studentët e diplomuar me suksese në karrierën e tyre profesionale si edhe me sipërmarrës dhe profesionistë pjesë e tregut të punës. Sipas Statutit të UET, programet e studimit konsultohen edhe me Bordin e Tregut të Punës. Në dokumentet e prezantuara Axxhenda e Bordit të Tregut të Punës, vihen re konsultime të ndryshme të organizuara në nivel departamenti dhe fakultetit për tematika që lidhen me dixhitalizimin dhe audiencën, kreativitetin, etj. Të ftuarit në këto seksione kane diskutuar me shembuj konkretë, si për fushatat e marketimit, reklamat mediat online, etj. (Shembull i prezantuar, aktiviteti i 12 Shtator 2024 “Sfidat e medias dhe transformimit digjital”, në partneritet me READ/AADF, AKKSHI, AMA, Euronews Albania, JMCH). <i>Evidenca 2. Statuti (shqip) _struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregut te punes 2023-2025</i> <i>Evidenca 12.2. Axxhenda Bordi i tregut te punes</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Sipas statutit të UET pjesëmarrja e studentëve është e garantuar në institucione si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, KSBC. Gjithashtu edhe në Planin Strategjik të UET është e përcaktuar se UET mbështet fuqizimin e rrjeteve ALUMNI, që ato të funksionojnë dhe të përfshihen gjithnjë e me shumë në strukturën konsultuese e drejtuese të universitetet, si edhe të angazhohen në projekte zhvilluese. Pranë fakulteteve janë të ngritura Bordet e Tregut të Punës të cilat kanë si anëtarë edhe ALUMNI të UET që ndër vite kanë pasur eksperiencë dhe karrierë të suksesshme në fushata respektive sipas programeve të studimit.



	Departamenti organizon mbledhje mujore ku janë të ftuar edhe studentët të zgjedhur nga programet respektive. Këshilli Studentor bën mbledhje mujore me Rektorin e Universitetit dhe përfaqësues të tjera të zyrave institucionale të UET ku diskutohen edhe pjesë të programeve mësimore dhe aktivitete e veprimtari mësimore. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregut te punes 2023-2025</i> Evidenca plotësuese pas vizitës - 31.01.2025 Axhenda e mbledhjes së departamentit me studentët			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësia përgjegjëse për këtë program studimi analizon në mbledhjet e tij me tematika të ndryshme edhe përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes e programit në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. UET ka ndërtuar marrëdhënie të forta bashkëpunimi me institucione publike dhe private, si dhe me rrjete profesionistësh. Mekanizmi kryesor për arritjen e tyre janë Bordet e Tregut të Punës të cilët kanë përfaqësues të bizneseve apo profesionistëve në treg, që lidhen me programet përkatëse të studimit. Në lëndë të veçanta, në varësi të tematikave janë të ftuar edhe profesionistë si folës dhe lektorë, duke i prezantuar studentët kështu me eksperiencat reale të tregut. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregut te punes 2023-2025</i> <i>Evidenca 12.2. Axhenda Bordi i tregut te punes</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UET i kushton kujdes përfshirjes së studentëve aktualë, ALUMNI, si edhe rrjeteve të organizmave profesionale dhe aktorëve të biznesit në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Bordet e Tregut të punës janë një mekanizëm i rëndësishëm në këtë drejtim. Kjo përfshirje siguron që programet të realizohen me sukses, të përmirësohen në vazhdimësi dhe të jenë në përputhje me objektivat e tyre formuese. Gjithashtu programet reflektojnë kërkesat e tregut për profesionistë në fushat e medias.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programet e studimit në UET ndërtohen në përputhje me vizioni dhe misionin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit. Sipas rregullores përkatëse programi i studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie publike”, përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. “Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Programi i studimit Master Profesional, synon ta pajisë studentin me: ▪ Koncepte të aplikuara, të specializuara; ▪ Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; ▪ Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative; ▪ Aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; ▪ Njohuri teorike bazë të fushës së studimit; ▪ Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; ▪ Aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës. ▪ Diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional.” Të gjitha këto njohuri dhe objektiva të programit synojnë të ndërtohen në harmoninë e krijuar midis aspektit teorik dhe punës aplikative duke përdorur zhvillimet e reja të tregut, sipas profileve respektive të këtij programi studimi. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim</i>

	<i>dhe Media Digjitale</i> Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përmbush standardet e strukturës akademike dhe detyrimet ligjore. Fakulteti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose aktivitetet mediatike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Ai organizon periodikisht forume, konferenca e bashkëbisedime me pedagogë e student. Një nga ato është konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, dhe Forumet e UET. Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në, projekte dhe aktivitete jashtë kurrikulës. Kjo arrihet nga detyrat e kursit, puna në terren, projekte, konferenca, dhe aktivitete mediatike. Në UET janë krijuar edhe funksionojnë disa klube studentore. Qëllimi i këtyre klubeve është që të pasurojë jetën sociale të studentëve si dhe të ofrojë mundësi për zbatimin në praktikë të njohurive të marra në programet e studimit. Në bashkëpunim me organizma të tjerë të UET, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale organizon aktivitete ku marrin pjesë studentët e të gjitha programeve. Këto aktivitete shërbejnë gjithashtu për të forcuar frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit në grup dhe veprimtarisë multi-disiplonore. Ditët e Studimeve Shqiptare është një aktivitetit i standardizuar dhe i përvitshëm që përveç konferencave dhe forumeve me tematikë të caktuar, realizon edhe publikime për studimet më të mira.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Sikurse përshkruan në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, rregullimi dhe financimi i kërkimit shkencor në UET bëhet si nëpërmjet projektsh, ashtu edhe me financimin e UET. Sipas një përzgjedhje të drejtimeve prioritare UET për fakultete dhe departamente të ndryshme nisur nga prioritetet vjetore UET mbështet me fonde nëpërmjet Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve krijimin e një klime të favorshme e stimuluese për

	kërkimin shkencor.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se në këtë program studimi janë të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe ato janë të lidhur edhe me objektivat madhorë të institucionit. Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Ditët e Studimeve Shqiptare në UET janë një veprimtari e cila bashkërendon objektivat e mësimdhënies me aktivitetet ekstrakurikulare dhe kërkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Projektet e ndryshme si në kuadër të rrjeteve ndërkombëtare universitare ashtu edhe ato vetë UET inkurajojnë dhe mundësojnë kërkimin. “Strategjia e kërkimit shkencor në UET” (2021-2025) thekson që: “UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitar kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për të arritur këtë, kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentet që do të përdorë UET për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor.” <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.</i> <i>Evidenca.3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte	Departamenti i Shkencave Humane dhe komunikimit mbështet kërkimin shkencor si nëpërmjet projekteve si për stafin akademik, ashtu edhe për përfshirjen e studentëve në këto grupe kërkimore. Një praktikë e mirë në këtë drejtim janë aktivitetet në kuadër të

me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	“Ditët e Studimeve Shqiptare”. Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025. Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Aktiviteti kryesor i kërkimit shkencor është konferenca e përvitshme Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, organizuar me panele sipas fakulteteve. Ato të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave në fushën e studimeve dhe kërkimit. Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH) është një ndër aktivitetet e rëndësishme të UET dhe përmbush edhe standardet ndërkombëtare të publikimeve. Ndërsa në fillim të vitit akademik zhvillon DSSH junior me prezantimin e punimeve të studentëve. UET fton herë pas here të ftuar nga bota akademike dhe tregjet në leksionet e hapura me studentët. Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025. Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i Studimit Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” përmban lëndë dhe module të përshtatshme për tu dhënë studentëve njohuri të nevojshme për tregun e punës. Kjo shihet edhe në raportet e lëndëve praktike dhe profesionale dhe orëve praktike. Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i Studimit Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” nuk aplikon pajisjen e studentëve me ndonjë licencë specifike.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe	Programi i Studimit Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” i pajis studentët me diplomë Master Profesional “Komunikim dhe Media Digjitale” dhe nuk ka lidhje me licenca specifike apo akte rregullative për

rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	profesionet e rregulluara.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se <i>Strategjia e kërkimit shkencor në UET</i> (2021-2025) është dokumenti i rëndësishëm që përcakton ecurinë e kërkimit shkencor. Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit është njësi qendrore e kërkimit shkencor. Ndër aktivitetet kryesore të kërkimit shkencor është konferenca e përvitshme Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, organizuar me panele sipas fakulteteve. Aktivitetet të tilla ndihmojnë personelin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave në fushën e studimeve dhe kërkimit. Programi i Studimit Master Profesional me profile "Gazetari Digjital", "Marketing", "Marrëdhënie Publike" i pajis studentët me diplomë Master Profesional dhe për këtë program studentët nuk marrin licenca specifike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Baza fillestare për të ndërtuar format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve është e përcaktuar në rregulloren e UET, specifikisht “<i>Neni 16. Organizimi i programeve të studimit</i>” dhe “<i>Neni 17. Planifikimi i procesit mësimor</i>”. Konkretisht “<i>Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale, punim diplome, Provim të Përgjithshëm Përfundimtar, projekte etj.</i>” Programi i studimit ofron një gamë të gjerë formash për mësimdhënie, mësimnxënie dhe transmetim të dijeve. Specifikisht këto forma janë të trajtuara edhe në Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale. Këto forma përfshijnë leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi dhe provime. Detyrat e kursit dorëzohen nga studentët përpara përfundimit të javëve mësimore dhe janë edhe ato pjesë e vlerësimit. Gjithashtu, në leksione të veçanta janë të ftuar edhe ekspertë të fushave të ndryshme, mediat, bizneset e lidhura me programin e studimit, duke u bërë kështu një tjetër element pasurues dhe mundëi për këndvështrime praktike dhe njohuri të përditësuar profesionale. Dejatet specifike për secilën nga lëndët janë të specifikuara në syllabuset të cilat u bëhen prezent studentëve në fillim të vitit akademik/semestrit. <i>Evidenca 5. Rregullore UET</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit, personeli akademik ndërton edhe syllabuset e lëndëve. Syllabuset u përgjigjen si nevojave të lëndës për kuptueshmëri sa më të mirë të saj, ashtu edhe integritit të njohurime teorike me ato praktike dhe ecurisë së mësimdhënies. UET angazhohet për të ofruar një mjedis arsimor të barabartë dhe të përkushtuar për të përmbushur nevojat dhe larmitë e studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Syllabuset e çdo lënde kanë të përcaktuar metodat pedagogjike të përdorur në seminarin e rrëdhës, literaturën, të detyrueshme ose të rekomanduar si edhe format e vlerësimit të dijeve. Baza materiale e përdorur për mësimdhënie si kompjuteri dhe video

	projektori, diskutimet në grupe në seminar, ekspertët e ftuar në auditor, forumet dhe detyrat praktike janë disa nga mjetet e përdorura. Krahas tyre përdoren edhe platformat online si Google Classroom, ku mund të diskutohet për çdo aspekt të programit, siç janë detyrat, vlerësimet dhe leksionet. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19.1 A III -5-1 Format syllabusi</i> <i>Evidenca plotësuese pas vizitës: Student- center learning, teaching and assesment policy</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UET mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave të mësimdhënies nëpërmjet formave të ndryshme siç janë inkurajimi i kërkimit shkencor individual, trajnimi i pedagogëve të rinj dhe sidomos pedagogëve që janë PAK, përfshirjen e pedagogëve në projekte kërkimore dhe shkencore me universitete të huaja dhe të vendit, në kuadër të programeve me rrjetet e universiteteve dhe Erasmus +. Të gjitha format e mësimperme mundësojnë përputhjen e rezultateve të pritshme të mësimdhënies me nevojat e të nxënit. Dokumenti “Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët” përshkruan aktivitete ekstrakurikulare të bëra për inkurajimin e zhvillimit profesional të studentëve dhe pedagogëve. Në fillimin e vitit të ri akademik, UET organizon edhe trajnime afatshkurtëra për pedagogët e rinj. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 33. Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe/ose studentët</i> <i>Evidenca 11 Dokumenti G rregullore për Burimet njerezore</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë	Mbështetur në informacionet e përcjella, CV të pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, vlerësohet se pedagogët kanë kualifikim dhe eksperiencë të gjerë në mësimdhënie. Pedagogët kanë tituj dhe grada shkencore dhe janë të përfshirë në projekte të kërkimit shkencor. Këto cilësi kontribuojnë në kompetencën e tyre në shpjegimin e koncepteve dhe njohurive dhe përcjelljen e informacionit reciprok sipas lëndëve në programin e studimit. Metodatat e mësimdhënies, të cilat përshkruhen edhe në syllabuset e lëndëve, janë të larmishme

kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	duke kombinuar format e prezantimit, grupet e studimeve dhe diskutimeve, si edhe teknikat e reja digjitale. Kjo qasje ndihmon në nxitjen e mendimit krijues te studentët. Gjatë vizitës në UET dhe takimit me studentët dhe pedagogët, u plotësua informacioni lidhur me përdorimin në leksione të shembujve aktualë nga mediat, materialet audiovizive, duke bërë mësimin më koherent dhe praktik për studentët. Edhe në seminare pedagogët trajtojnë raste studimi dhe ushtrime, duke ofruar mbështetje për studentët që kanë paqartësi. Gjithashtu pedagogët ftojnë edhe personalitete të fushave të ndryshme të japin leksione të hapura. Zbatimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies nxit të mësuarin aktiv dhe krijues të studentët, duke ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit dhe mbështetjes midis pedagogëve dhe studentëve. UET ka ndërtuar mësimin duke u bazuar në qasje “Student center learning approach”. Gjithashtu studentët nxitin të zhvillojnë autonominë e tyre dhe të menduarin kritik. Kjo realizohet nëpërmjet punimeve në grup dhe prezantimeve. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabusët e lëndëve</i> <i>Evidenca 20. CV</i> <i>Evidenca 33. Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i> <i>Evidenca plotësuese pas vizitës: Student- center learning, teaching and assesment policy</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit si njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” në UET angazhohet aktivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Kjo arrihet përmes një procesi të rregullt dhe sistematik, ku studentët luajnë një rol të rëndësishëm. Vlerësimi realizohet si në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamenti, të cilat përmes pyetësorëve mbledhin mendimet e grupeve të ndryshme studentore. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon me njësitë kryesore përgjegjëse për programin e studimit dhe kryen aktivitete të ndryshme për të testuar njohuritë programin e

	studimit. Rezultatet e monitorimit pasqyrohen në raporte, të cilat i përcillen Rektoratit për të ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve mësimore. Evidenca 5. Rregullore UET Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UET ka krijuar struktura në nivel institucional për përmirësimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) luan një rol kyç në këtë proces, duke zhvilluar aktivitete sipas një plani kalendarik të përvitshëm dhe duke bashkëpunuar ngushtë me njësitë bazë për monitorime të vazhdueshme. Përbërja e këtij komisioni propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati i Universitetit dhe kjo është një strukturë e përhershme në organigramën e universitetit. Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e saj rregullohen me rregullore specifike. KSBC vlerëson periodikisht proceset e mësimdhënies dhe prodhon raporte të cilat shërbejnë për përmirësimin e cilësisë në universitet. Gjithashtu edhe departamentet e ndryshme përgjegjëse për programin e studimit organizojnë çdo fillim viti rishikimin e syllabuseve të lëndëve duke i pasuruar ato. Personeli akademik merre pjesë në trajnime dhe projekte që nxisin kërkimin shkencor dhe përditësimin e tyre me literaturën e re. UET përdor disa metoda vlerësimi për pedagogët, s nga përgjegjësit e dept.apo dekani, nga Komisioni i vlerësimit të performancës, apo edhe fokus- grupet me studentët. Evidenca F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë Evidenca 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC Evidenca 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC Evidenca 30.9 Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset Evidenca 30.13 Metodologjia e punës së KSBC Fokus grupet Evidenca 30.11. Shembull _ Komunikim dhe shpërndarje e relacionit të KSBC Evidenca 30.12. Shembull_Relacion DMM_Monitorimi i Silabuseve_Sem I 2021-2022 Evidenca 30.16 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori / kolegu Evidenca 30.20 Shembull vlerësimi nga eprori

Konkluzione	GVJ vlerëson se UET, Fakulteti Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, dhe Departamenti Shkencave Humane dhe Komunikimit, garantojnë një proces të të nxëniet që vendos studentin në qendër. Duke përdorur metodat dhe praktikën më të mira bashkëkohore, studentët arrijnë rezultatet e synuara dhe objektivat formuese të programit përmbushen. Studentët zhvillojnë kompetencat e tyre akademike dhe profesionale në përputhje me standardet arsimore. Cilësia e pedagogëve dhe kualifikimet e tyre përshtaten me lëndët që ata japin mësim UET ka krijuar struktura, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili vlerëson periodikisht proceset e mësimdhënies dhe prodhon raporte të cilat shërbejnë për përmirësimin e cilësisë në universitet. UET përdor disa formate vlerësimi të ecursisë së mësimdhënies, si nëpërmjet drejtuesve të Dept. / dekanëve, si edhe fokus grupeve me studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mbështetur në bazën dokumentare të përcjellë nga UET shihet se rregullorja përkatëse e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional me profile “Gazetari Digjital”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” përcakton qartë kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kjo rregullore jep qartësisht mënyrat e vlerësimit, përfshirë testet me shkrim dhe vlerësimet e performancës akademike gjatë vitit, të cilat kombinohen sipas lëndëve. Vlerësimi përfundimtar i studentit është rezultat i vlerësimit të provimit të ndërmjetëm, detyrave të zhvilluara gjatë kursit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare, detyrat praktike dhe provimit përfundimtar. Në syllabuset e lëndës dhe

	me çdo pedagog që në fillim të vitit akademik prezantohen edhe raportet që zënë elementët e mësipërm në vlerësimin final të çdo lënde. Këto vlerësime u bëhen të njohur studentëve në fillim të vitit akademik. Studentët mund t'i marrin këto informacion edhe nga koordinatorja e departamentit. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të vitit akademik, pedagogët e çdo lënde informojnë studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që do të përvetësohen. Kjo është e përcaktuar edhe në rregulloren përkatëse dhe syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi kombinon kontrollit e dijeve gjatë semestrit, provimit të ndërmjetëm dhe provimit përfundimtar. Raportet midis tyre dhe pesha specifike e tyre në vlerësimin përfundimtar të studentit jepen në syllabusin e çdo lënde. Pikat e vlerësimit shkojnë nga 0 në 100 dhe konvertohen në nota 4-10, si edhe me germa F- A. Studentët përdorin edhe platformat elektronike të komunikimit LMS dhe TEAMS, për të marrë informacionin për vlerësimet e lëndëve. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke lejuar studentët të paraqesin kompetencat e fituara. Format tradicionalisht të njohura kombinohen me format alternative të vlerësimit. Këto janë edhe në varësi të procesit të mësimdhënies. Hartimi i tezave të provimit i përshtatet natyrës së lëndës.
Konkluzione	GVJ vlerëson se UET ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, duke siguruar një proces vlerësimi të drejtë dhe të strukturuar, duke i dhënë peshë elementëve të ndryshëm të vlerësimit. Rregullorja e programit të

	<i>studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale, si edhe syllabuset e lëndëve i japin të qarta këto dhe u bëhen të ditur studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në syllabuset e lëndëve, RVB dhe rregulloren e këtij programi studimi, shihet qartë se vlerësimet e studentëve janë të shpërndara përgjatë semestrit, duke siguruar një monitorim të vazhdueshëm të përparimit të studentëve. Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dhe aftësive profesionale është i strukturuar në mënyrë të qartë. Provimi i ndërmjetëm, detyrat e kontrollit dhe provimi përfundimtar, që realizohen në përputhje me aktet rregullative të UET zhvillohen brenda afateve kokore të përcaktuara. Tezat e provimeve janë të sekretuara, me bar-code krijon mundësi më të madhe për paanëshmëri dhe vlerësim të saktë të studentëve. Evidencat e paraqitura, përfshirë syllabuset dhe format e kontrollit, demonstrojnë angazhimin e institucionit për një proces të qëndrueshëm dhe cilësor vlerësimi. Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në universitetet u vlerësua fakti i disa formave të ndryshme të vlerësimit përgjatë gjithë vitit akademik. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe me forma të ndryshme. Vlerësimit janë transparente dhe objektive, duke synuar më shumë drejt formimit të tyre se sa procedura e thjeshtë e dhënies së një note. Siç shënohet në RVB dhe ashtu si u përshkrua gjatë vizitës në

transparencën.	institucion, që prej vitit akademik 2016-2017 UET në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, AADF, aplikojnë, (jo për të gjitha lëndët) një format të ri elektronik vlerësimi. “Clean Scoring” të provimeve/testimeve është një formë bashkëkohore e vlerësimit të studentëve. Sugjerohet shtrirja e kësaj forme vlerësimi edhe në programe apo lëndë të tjera, duke eksploruar mundësi të tjera teknologjike për të përmirësuar akoma më tej procesin e vlerësimit dhe për të mbajtur një nivel të lartë transparence dhe integriteti akademik. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës është i lidhur dhe mbështet te syllabusi, i cili bazohet në formatin e përcaktuar nga legjislacioni dhe nga aktet rregullatore të miratuara nga UET. Në syllabus është e qartësuar struktura e testimit/vlerësimit të njohurive të studentëve. Procedurat dhe afatet e vlerësimit janë të përcaktuara në aktet rregullative të institucionit dhe në udhëzuesin për provimet. Ato ofrojnë një kornizë të fortë për menaxhimin e procesit. UET i ka të ndara lëndët edhe në bazë të tipologjive, ku me tipologjinë I janë lëndët ku pjesa më e madhe e përmbajtjes së programit të tyre është aplikative dhe praktike, ndërsa në lëndët e tipologjisë II janë lëndët me përmbajtjen më të madhe të tyre me informacione teorike. Ndarja në përqindje midis aktivizimit në seminare, detyrave të kursit, provimit të ndërmjetëm dhe provimit final ndryshon në varësi të lëndëve. Dokumenti “ Sistemi i vlerësimit të studentëve (ndryshuar me Vendim Senati Nr. 20, datë 20,12,2023) jep informacion të plotë mbi sistemin e vlerësimit. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: a. Provimi i ndërmjetëm [formati A.IV.2.1]; b. Provimi përfundimtar [formati A.IV.2.2]; c. Riprovimi [formati A.IV.2.3]; d. Përmirësimi [formati A.IV.2.3]; Si rregull teza e provimit përbëhet nga 3 kategori pyetjesh: si në Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar [formati A.IV.2.4]. a. Pyetje që kontrollojnë njohuritë, 20 - 30% e tezës; b. Pyetje që testojnë aftësitë analitike, 40 - 50% e tezës; c. Pyetje që kërkojnë mendimin dhe qëndrimin individual



	<i>të studentit (në formën e esesë argumentuese, raste të studimit/kazuse, ose ushtrime), 20-30 % e tezës.</i> Tezat e provimeve përgatiten nga titullarët e lëndëve në bashkëpunim me personelin akademik dhe më tezat miratohen nga përgjegjësi i departamentit përpara zhvillimit të provimeve. Ky proces siguron një nivel të lartë të mbikëqyrjes dhe përshtatshmërisë me standardet e pranura. <i>Evidenca 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> <i>Evidenca 7.3. Format i tezës së provimit përfundimtar</i> <i>Evidenca 7.4. Format i tezës së provimit të ndërmjetëm</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Institucioni ka formalizuar vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale, duke siguruar që çdo provim të shoqërohet me shënime dhe feedback për studentët. Provimet shoqërohen edhe me seksionin e komenteve ku pedagogu argumenton vlerësimin e tij. Pedagogët mund të zhvillojnë edhe seanca me shpjegime për studentët ku mund të marrin detaje dhe përgjigje specifike për vlerësimet e provimeve. Pas sesionit sqarues, pedagogu dorëzon vlerësimet në sekretarinë mësimore. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> <i>Evidenca 7.3. Format i Tezës së Provimit Përfundimtar</i> <i>Evidenca 7.4. Format i Tezës së Provimit të Ndërmjetëm</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregulloret e programit të studimit dhe rregulloret e tjera të UET kanë të përcaktuar procedurat e zhvillimit të provimit. Sipas rregullores "... Studentët duhet të paraqiten në provim me një dokument identifikimi. Ata futen në sallën e provimit nga pedagogu i lëndës dhe/ose pedagogët e caktuar për të siguruar mbarëvajtjen e provimit, dhe vendosen nëpër banka sipas rendit alfabetik që kanë në regjistër; Studentët duhet të lënë në një vend të veçantë (në bankat e para) çantat, librat, leksionet dhe çdo material tjetër mësimor e informativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lëndën e provimit. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi."

	Provimi mbikëqyret nga dy pedagoge që caktohen nga departamenti. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të koordinatores që bën sekretimin e tezave, të monitoruesve, të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, apo të tjerë monitorues, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Në zbatim të Kodit të etikës, plagjatura dhe kopjimi dënohen dhe vlerësohen me notën 4. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> <i>Evidenca 16. A.II. Kodi i Etikës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	UET ka krijuar një sistem të qartë dhe efikas për vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve, duke siguruar që rezultatet të bazohen në meritë. Sekretimi i provimeve garanton një vlerësim të drejtë dhe individual, duke shmangur çdo formë ndikimi të jashtëm. UET ka në zbatim mekanizimin e sekretimit të tezave të provimeve. Bazuar në rregulloren përkatëse, “Tezat e korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student.” Korrigjimi i provimeve nga pedagogët e lëndës. Rregjistrimi i pikëve në procesverbalin analitik pas provimit ofron transparencë dhe ndihmon studentët të marrin informacionin e nevojshëm në kohë. Kjo evidentohet përmes evidencave të dokumentuara, si syllabuset dhe udhëzimet për procedurat e provimeve, por edhe nga përgjigjet e studentëve dhe personelit akademik gjatë takimeve që u zhvilluan në institucion. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe	Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe informacioneve të mbledhura gjatë vizitës në institucion konstatohet se UET ka një procedurë të qartë dhe të rregullt për të garantuar të drejtat e studentëve në lidhje me vlerësimin e tyre. Informimi për rezultatet paraprake përmes sistemit LMS dhe në kohë sa më të shpejtë është një hap pozitiv që lejon studentët të kenë akses të menjëhershëm në informacionin e tyre.

procedurat e vlerësimit.	Organizimi i seancave sqaruese, ofron mundësinë për të diskutuar dhe verifikuar rezultatet, duke inkurajuar një kulturë transparence. Gjatë këtyre seancave, studentët diskutojnë me pedagogun e lëndës për vlerësimi, më pas mund të diskutojnë edhe me përgjegjësin e departamentit, me anën e një ankimi me shkrim. Dekani ngre një komision <i>ad-hoc</i> të përbërë nga tre pedagogë për të diskutuar mbi notën dhe për të bërë rivlerësimin e saj. Vlerësimi i komisionit është përfundimtar për studentin. Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura për ankimimin e vlerësimit është gjithashtu e detajuar në rregulloren kryesore të UET dhe në rregulloren e programit të studimit Master Profesional “Komunikim dhe Media Digjitale”. Dekanati ngre komisione <i>Ad-hoc</i> për të trajtuar dhe rishikuar provimet e studentëve, në rastet kur studenti është i pakënaqur me vlerësimin e notës. Edhe gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën se ata e kanë mundësinë për të komunikuar dhe kërkuar rishikimin e notës. Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale Evidenca 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve			
Konkluzione	GVJ vlerëson se testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Kjo është e parashikuar në syllabuset e lëndët. UET ka disa tipe provimesh si Provimi i ndërmjetëm; Provimi përfundimtar; Riprovimi; dhe Përmirësimi. Provimet shoqërohen edhe me seksionin ku pedagogu argumenton vlerësimin e tij. Baza rregullatore e UET ka të përcaktuar edhe procedurën e dhënies së provimit dhe afatet e dhënies së vlerësimeve. Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notat dhe dekanati ngre komisione <i>Ad-hoc</i> për të trajtuar dhe rishikuar provimet e studentëve, në rastet kur studenti është i pakënaqur me vlerësimin e notës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional “Komunikim dhe Media Digjitale” është hartuar i tillë që të garantojë thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Lëndët dhe përmbajtja e tyre krijojnë mundësinë për një ecuri graduale në njohuri, teknika, teorike dhe praktike. Kjo qasje dhe kombinimi i detyrave praktike të kursit, punimeve të diplomës, aktivizimin në evente të ndryshme nxit kreativitetin, duke e bërë programin të përshtatshëm për nevojat e tregut dhe kërkesat profesionale. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 14. Kurrikula e programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master Profesional “Komunikim dhe media digjitale” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme, përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimin. Kurrikula është projektuar për të ofruar një balancë të mirë midis formimit teorik dhe praktikë. Përfshirja e lëndëve si “Komunikim Masiv Bashkëkohor”, “Strategji Komunikimi me mediat e reja”, “Marketing digjital dhe mediat sociale” në planin mësimor kontribuon në një zhvillim të plotë të studentëve, duke i pajisur ata me aftësi që janë thelbësore për suksesin në fushat e komunikimit dhe ndërveprimit. Këto lëndë ndihmojnë në formimin e njohurive të nevojshme për të kuptuar zhvillimin e shoqërisë në ditët e sotme. Evidencat e paraqitura, si plani mësimor dhe syllabuset, demonstrojnë angazhimin e institucionit për të siguruar një arsimim të gjithanshëm dhe cilësor. <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i>

	<i>Evidenca 14. Kurrikula e programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Syllabuset e lëndëve kanë në fillim të tyre një kuadër përmbledhës të lëndës dhe objektivave të saj formues. Matja e njohurive të studentëve bëhet nëpërmjet provimeve dhe rezultatet e provimeve janë edhe reflektim i procesit mësimor, njohurive të marra dhe nxitjes për dije dhe informacion që lënda shkakton tek studentët. Në orët e fundit të seminareve, pedagogët bëjnë një përmbledhje të lëndës dhe eidentojnë cilat do të jenë pikat kryesore ku ata do të duhet të përqendrohen si për provimin dhe si lidhen njohuritë e marra me zbatimin e tyre në praktikën e punës. <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 14. Kurrikula e programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Syllabuset e lëndëve japin të qartësuar se cilat do të jenë objektivat dhe aftësitë që do të fitojë studenti me zhvillimin e secilës nga lëndët specifike në programin e studimit. Sipas syllabuseve të lëndëve, për ato të Tipologjisë I të cilat janë më tepër të lidhura me aftësitë profesionale vlerësimi mbështetet në detyrat e kursit që janë dy dhe kanë secila nga 30% të vlerësimit dhe më pas provimi përfundimtar që ka 40% të vlerësimit. Ndërsa për lëndët e tipologjisë II të cilat kanë edhe më tepër karakter teorik, përsëri detyra e kursit kap 20% të vlerësimit. Edhe nga diskutimi me pedagogët e lëndëve të ndryshme gjatë vizitës në UET ata u shprehën se përpiqen ta ilustrojnë çdo orë mësimore me shembuj nga zhvillimet mediatike në vend, për të sjellë realitetet mediatike shqiptare dhe ndërkombëtare në orën e mësimi. Praktika profesionale është pjesë e detyrimeve akademike për këtë program studimi. Këto praktika zhvillohen në institucione të ndryshme mbi bazën e marrëveshjeve që UET ka me to. Në rang universiteti janë zhvilluar projekte në kuadër të rrjeteve ndërkombëtare universitare si të projektit Erasmus + të cilat sigurojnë mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve. <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 14. Kurrikula e programit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 32. Tabela 5 Institucione dhe organizuese për praktikat</i>

	<i>profesionale</i> Evidenca 32.1 Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Leksionet e hapura janë një përvojë e përdorur me efektivitet nga UET. Bazuar në tematikat e veçanta të lëndëve, në orët e mësimit ftohet individë të spikatura si nga bizneset ashtu edhe nga organizata të tjera apo media për të ndarë me studentët ecurinë dhe sfidat në zhvillimet e përditshme në biznesin e tyre. Evidenca 32. Tabela 5 Institucione dhe organizuese për praktikat profesionale Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në rang universiteti, UET ka hartuar “Strategjinë e kërkimit shkencor” e cila ka të përcaktuar qartë objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre. Në kërkimin shkencor synohet të përfshihen edhe studentët sipas fushave specifike të studimit. Një aktivitet i rëndësishëm janë edhe “Ditët e Studimeve Shqiptare” dhe krahas saj edhe Junior Ditët e Studimeve ku prezantohen paper/kërkime dhe projekte të studentëve.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se lëndët dhe përmbajtja e programit krijon mundësinë për një ecuri graduale në njohuri, teknika, teorike dhe praktike. Kjo qasje dhe kombinimi i detyrave praktike të kursit, aktivizimin në evente të ndryshme nxit kreativitetin, duke e bërë programin të përshtatshëm për nevojat e tregut dhe kërkesat profesionale. Përfshirja e lëndëve si “Komunikim Masiv Bashkëkohor”, “Strategji Komunikimi me mediat e reja”, “Marketing digjital dhe mediat sociale” në planin mësimor kontribuon në një zhvillim të plotë të studentëve, duke i pajisur ata me aftësi që janë thelbësore për suksesin në fushat e komunikimit dhe ndërveprimit. Edhe pedagogët e lëndëve të ndryshme e ilustrojnë çdo orë mësimore me shembuj nga zhvillimet mediatike në vend, për të sjellë realitetet mediatike shqiptare dhe ndërkombëtare në orën e mësimit. Praktika profesionale është pjesë e detyrimeve akademike për këtë program studimi. Këto praktika zhvillohen në institucione të ndryshme mbi bazën e marrëveshjeve që UET ka me to. Një aktivitet i rëndësishëm janë edhe “Ditët e Studimeve Shqiptare” dhe krahas saj edhe Ditët e Studimeve ku prezantohen kërkime dhe projekte të studentëve.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyllet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbylëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbylëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	UET harton procedurën për realizimin e provimit final dhe e prezanton atë te studentët në fillim të semestrit. Ndarja e studentëve që do të kryejnë punim diplome dhe atyre që do të kryejnë Provim të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) realizohet duke u bazuar tek nota mesatare e realizuar në të gjitha vitet akademike. Pragu i kësaj note është 7.5. Në rregulloren e këtij programi studimi janë të përcaktuara të gjitha procedurat që duhen realizuar për të arritur tek punimi i diplomes apo PPP. Studenti duhet ti ketë shlyer të gjitha detyrimet paraprake përpara se të bëjë punimin e diplomës ose PPP. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 7.3. Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbylëse.	Në Rregulloren e programit të studimit “MP Komunikim dhe Media Digjitale” është e përcaktuar se pedagogët që udhëheqin temat e diplomave, zhvillojnë seanca metodologjike me studentët, sipas një kalendarit të njoftuar paraprakisht. Gjithashtu, Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit jepen të gjitha detajet e procedurës për realizimin e punimit të diplomës që nga zgjedhja dhe miratimi i temës, organizimi i seancave metodologjike, afatet kohore, citimi i burimeve, ngritja e komisioneve për vlerësim e të tjera. Kjo procedurë është e detajuar me specifikat e veta për diplomat e nivelit Bachelor, Master Shkencor apo Profesional dhe Doktoraturë. <i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Kriteri i mesatares 7.5 është kufiri që lejon realizimin e detyrimeve përmbyllëse me punim diplome apo provim të përgjithshëm përfundimtar, (PPP). Edhe studentët me mesatare mbi 7.5 mund të zgjedhin të mos bëjnë punim diplome, por PPP. Formati i tezës së Provimit përfundimtar ka: - Grup pyetjesh për kontroll njohurish - 25% e vlerësimit; - Grup pyetjesh analitike – 50% e vlerësimit; - Grup pyetjesh alternative (detyrë praktike) – 25% e vlerësimit. <i>Evidenca 7.3. Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar</i> <i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo njëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Pedagogët që udhëheqin temat e diplomave, zhvillojnë seanca metodologjike me studentët, sipas një kalendari të njoftuar paraprakisht. Kjo është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit “MP Komunikim dhe Media Digjitale”. Dokumenti i veçantë “<i>Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>” përcakton edhe mënyrën e organizimit të seancave metodologjike. Departamenti ka detyrë të garantojë që përmbajtja e temës së përzgjedhur është në profilin e programit të studimit dhe të pedagogut të përzgjedhur për të. Më pas departamenti publikon edhe listën e temave të diplomave të miratuara dhe pedagogët udhëheqës. Udhëheqësi i temës në seancat metodologjike më të gjithë studentët nën drejtim i orienton ata si për përmbajtjen, ashtu edhe për ndërtimin strukturën, gjetjen dhe përdorimin e burimeve parësore dhe dytësore për punimin, hartimin e hipotezave dhe nxjerrjen e konkluzioneve. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Seancat metodologjike të zhvilluara nga pedagogu i caktuar për udhëheqjen e diplomës u japin studentëve orientime për të gjitha aspektet e kërkimit dhe shkrimit të punimit. Ato orientojnë studentin edhe në realizimin e anketimeve/testimeve dhe mbledhjes së informacionit dhe të dhënave sasiore si burime të para, si edhe për mënyrën e përpunimit të të dhënave.

	<i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për vlerësimin e punimeve të diplomës ngrihet një komision vlerësimi. Studenti vlerësohet me pikë nga secili anëtar i komisionit, pedagogu udhëheqës si edhe oponenti. Rezultantja e totalit të këtyre pikëve konvertohet proporcionalisht në notë. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm PPP, studenti vlerësohet me notë. <i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti pajiset me Diplome dhe me Suplementin e Diplomës nga Sekretaria mësimore, brenda një afati 6-mujor. Sekretaria verifikon rezultate e të gjitha provimeve, praktikes, punimit të diplomës apo PPP dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera sipas programit të studimit. Në periudhën tranzitore deri në marrjen e diplomës përfundimtare, Sekretaria mësimore e pajis studentin një vërtetim për diplomën e lëshuar dhe listën e notave. Studentët mund të marrin edhe një kopje të certifikuar nga UET të programit mësimor. <i>Evidenca 10. Dokumenti BII Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Arkivimi i punimeve të diplomave në formatin printuar bëhet në Bibliotekën e UET dhe zyrën e Arkiv/protokoll. Në formatin elektronik punimet e diplomave depozitohen në kordinatoren e Departamentin dhe më pas kalojnë edhe në Arkiv/ protokoll. Rregullorja e programit të studimit nuk përcakton afat se për sa kohe ruhen këto punime.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UET harton procedurën për realizimin e provimit final dhe e prezanton atë te studentët në fillim të semestrit. Kriteri i mesatares 7.5 është kufiri që lejon realizimin e detyrimeve përmbyllëse me punim diplome por provim të përgjithshëm përfundimtar PPP. Pedagogët që udhëheqin temat e diplomave, zhvillojnë seanca metodologjike me studentët, sipas një kalendari të njoftuar paraprakisht. Seancat metodologjike të zhvilluara nga pedagogu i caktuar për udhëheqjen e diplomës u japin studentëve orientime për të gjitha aspektet e kërkimit dhe shkrimit të punimit. Ato orientojnë studentin edhe në realizimin e anketimeve/testimeve dhe mbledhjes së informacionit dhe të</i>

	dhënave sasiore si burime të para, si edhe për mënyrën e përpunimit të të dhënave. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm PPP, apo punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Infrastruktura e brendshme e UET është e përshtatshme për të realizuar programin e studimit. Institucioni ka ambiente të përshtatshme, laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe software të cilët ndihmojnë në realizimin e programeve për median dhe komunikimin (Microsoft 365 e plotë Publisher, access, Communicator. UET ka internet në të gjitha ambientet e tij. UET ka lidhur marrëveshje me mjaft institucione për të siguruar realizimin e praktikave profesionale. Edhe Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit ka Bordet e tij të punës bashkëpunon me tregun e punës për të realizuar praktikat profesionale. <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregu të punës 2023-2025</i> <i>Evidenca 12.2. Axhenda e Bordit të tregut të punës</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim	Praktikat e studentëve realizohen në përputhje me programin e studimit. Studentët e Master Profesional me profile “Gazetari Digjitale”, “Marketing”, “Marrëdhënie Publike” atashohen pranë institucioneve mediatike, apo organizmave kryesisht në zyrat e shtypit ose në redaksitë e lajmeve. Kjo u shërben atyre për të rritur kompetencat e tyre profesionale dhe për të njohur zbatimin e njohurive në terrenin aktiv të vendit të punës.

përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Krahas praktikës, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit i mbështet ata gjatë gjithë viteve të studimit duke i informuar për aktivitetet edukuese, aplikime për intership dhe punë, si edhe për pjesëmarrje në projekte për të rritur aftësitë profesionale. <i>Evidenca E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>Evidenca 32. Tabela 5 Institucione dhe organizuese për praktikat profesionale</i> <i>Evidenca 34. Protokoll-Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është e përfshirë në kurrikulën mësimore. Ajo ka 6 kredite ECTS. Pra janë 180 orë pune për studentin. Nga të cilat 8 orë zhvillohen në auditor. 22 orë janë punë individuale dhe 150 orë zhvillohen në një institucion/organizatë/ media. Në përfundim të praktikës, studenti dorëzon dosjen ku ndodhet edhe vlerësimi i pedagogut. Një vlerësim për studentin jep edhe personi i cili e ka shoqëruar në institucion/ media. Vlerësimi përfundimtar për praktikën bëhet nga komisioni vlerësues. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 14. Kurrikula e programit të studimit MP Komunikim dhe Media Digjitale</i> <i>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 32.2 Dokumenti B.I.4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga studenti)</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UET ka infrastruktura e brendshme të përshtatshme për të realizuar programin e studimit, ambiente të përshtatshme, laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe softuerë të cilët ndihmojnë në realizimin e programeve për median dhe komunikimin, dhe internet në të gjitha ambientet e tij. UET ka lidhur marrëveshje me mjaft institucione për të siguruar realizimin e praktikave profesionale. Edhe Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit ka Bordet e tij të punës bashkëpunon me tregun e punës për të realizuar praktikat profesionale. Praktika ka 6 ECTS dhe vlerësohet me notë.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbuset	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, rezulton se për realizimin e këtij programi studimi janë angazhuar pedagogë me tituj dhe grada shkencore, dhe konkretisht: Në cilësinë e stafit akademik efektiv, në vitin 2024-2025 (por edhe një vit më parë është ruajtur i njëjti raport), nga 11 pedagogë të angazhuar, me statusin PAE rezultojnë 2 Prof. Dr 3 Prof.As 2 Dr 1 Phd 1 Msc Ndërsa stafi PAK përbëhet nga 2 pedagogë me gradën shkencore 1 Dr 1Msc. Përbërja e këtij stafi është e profileve të ndryshme akademike, kryesisht në shkencë humane dhe në shkencat e komunikimit, por edhe në fushat e mësimdhënies që përputhen me hartimin e kurrikulës së këtij programi. Evidenca që lidhet me CV e stafit, justifikon në mënyrë të detajuar edhe disiplinat ku janë specializuar të japin mësim ligjëruesit në këtë program. <i>E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i> <i>E. 20. CV e stafit MP në Komunikim dhe Media Digjitale</i>

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<i>E. Dokumenti G II</i> Institucioni garanton që personeli akademik aktual të përmbushë në mënyrë të plotë dhe në përputhje me ligjin ngarkesën mësimore të programit të studimit. Të dhënat e disponueshme pasqyrojnë nivelin e lartë akademik të stafit të angazhuar, ku pjesa më e madhe është e punësuar me kohë të plotë në Universitetin European të Tiranës. Dokumentacioni tregon gjithashtu se PAE mbulon rreth 85% të ngarkesës mësimore, ndërsa PAK përfaqëson rreth 15%, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. <i>E. 0.2 Tabela përmbledhëse për Aneks</i> <i>E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i> <i>E. 20. CV e stafit MSh Komunikim dhe Media Digjitale</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në analizën e departamentit për periudhën 2018-2025, rezulton se institucioni ka siguruar qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv. Gjatë periudhës së akreditimit, stafi është punësuar në përputhje me procedurat e rregullta, me kontrata ligjore dhe pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke respektuar dispozitat ligjore dhe rregulloret institucionale. Për personelin akademik me tituj dhe grada shkencore, kontratat janë pa afat; për PAE pa grada dhe tituj, kontratat janë njëvjeçare; ndërsa për PAK, kontratat janë semestrale me të drejtë rinovimi. Të gjitha kontratat nënshkruhen nga Rektori. Statuti, Rregulloret e Institucionit dhe Kodi i Etikës përbëjnë dokumentet bazë që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe shërbejnë si bazë për hartimin e kontratave të punës. <i>E.2 Statuti i Universitetit European të Tiranës.</i> <i>E.7 Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale"</i> <i>E. 16. A.II. Kodi i Etikës</i> <i>E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i> <i>E. 11. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E.44.1 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit PAE</i> <i>E.44.2 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit PAK</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Dokumentet e brendshme të institucionit përcaktojnë se vlerësimi i stafit kryhet jo vetëm gjatë procesit të rekrutimit, por edhe gjatë gjithë periudhës së punës. Thirrjet për rekrutim bëhen duke marrë parasysh nevojat konkrete të departamentit, ekspertizën e kandidatëve dhe ngarkesën mësimore. Qëllimi është përzgjedhja e personelit me kualifikimet e nevojshme, në përputhje me përmbajtjen e programit të studimit. Institucioni angazhohet për menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, duke ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe duke ofruar mbështetje për

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	zhvillimin profesional të stafit. Përzgjedhja e stafit realizohet në mënyrë transparente, përmes ngritjes dhe funksionimit të një komisioni të caktuar nga njësia përkatëse. <i>E.11. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E.2 Statuti i Universitetit European të Tiranës.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni ka siguruar kushtet me personel ndihmës të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për realizimin e orëve laboratorike dhe ka garantuar ambiente të pajisura me aparaturë, mjete dhe programe aplikative të përshtatshme me nevojat e studentëve për aftësim praktik. <i>E.42.1 Infrastruktura akademike në funksion të programit</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Të dhënat e personelit mbledhen çdo vit akademik nga Zyra e Burime Njerëzore, e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, ku depozitohet i gjithë dokumentacioni si dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore, publikimet, realizimi i ngarkesës mësimore, aktivitetet dhe projektet kërkimore, CV e përditësuar. Në këto të dhëna bazohet Drejtuesi i Departamentit për të ndarë ngarkesën ndërmjet anëtarëve të stafit PAE dhe PAK. <i>E.44.1 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit akademik me kohë të plotë</i> <i>E.6 Dokument mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i> <i>E.11.G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E 11.2 Formular për ngarkesën (orë në auditor) e stafit akademik që mbulon lëndët e departamentit</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nëpërmjet bashkëpunimeve institucionale dhe marrëveshjeve, institucioni siguron personel të kualifikuar për instruktim, udhëheqje dhe mbikëqyrje të studentëve gjatë praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe veprimtarive të tjera të integruara në programin e studimit Master Shkencor në Shkencat e Komunikimit. Numri i pedagogëve mbikëqyrës përcaktohet në varësi të numrit të studentëve. Më tej këta pedagogë udhëheqës janë pjesë edhe e komisionit që ngre Departamenti për vlerësimin e praktikave mësimore të realizuara nga studentët. Si rregull, kur një student është i angazhuar në punë me kohë të plotë apo të pjesshme, gjatë periudhës së realizimit të praktikave mësimore, studentit puna e tij i njihet si realizim i praktikës mësimore, me kushtin që të jetë e të njëjtit fushë me programin e studimit. Ndërsa për realizimin e udhëheqjes së diplomave, Drejtuesi i Departamentit cakton një pedagog udhëheqës për çdo student.

	<i>E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese.</i> <i>E. 34.1 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Fondacionit "Fundjavë Ndryshe"</i> <i>E. 34.2 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Bashkia Tiranë</i> <i>E. 34.3 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Gazeta Liberale</i> <i>E.34.4 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Albtelecom</i> <i>E.34.5 Memorandum bashkëpunimi mes EEI dhe Balfin</i> <i>E.34.6 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe UET PRESS</i> <i>E.32.1 Dokumenti mbi praktikat profesionale</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikqyrës në ambientin pritës ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve dhe përgatitjen e raportit final dhe gjithashtu merr pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës, në bashkëpunim me institucionin. Ata angazhohen nëpërmjet vënies në zbatim të marrëveshjeve të hartuara më parë ndërmjet UET dhe institucionit pritës. Një pjesë e orëve të praktikës realizohen në ambientet e universitetit, ku ekzistojnë të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikave mësimore, me mjetet e nevojshme teknologjike që kërkon zhvillimi i sotëm i teknologjisë së komunikimit. <i>E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese.</i> <i>E.42.1 Infrastruktura akademike në funksion të programit</i>			
Konkluzione	Programi "Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale" me profile "Gazetari Digjitale", "Marketing", "Marrëdhënie publike"" në UET mbështetet nga një staf akademik i qëndrueshëm, me kualifikime të larta dhe përbërje shumëprofesionale që siguron mbulim cilësor të disiplinave dhe arritjen e objektivave formuese. Institucioni zbatohet rregullisht të qarta për rekrutimin dhe zhvillimin profesional të stafit, ofron burime të përshtatshme dhe bashkëpunime me partnerë, duke garantuar përgatitje praktike dhe relevancë në tregun e punës, në përmbushje të plotë të standardeve dhe kërkesave ligjore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, deri në vitin akademik 2021-2022, në selinë e vjetër

përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	në Bulevardin “Gjergj Fishta”, si pjesë e infrastrukturës për programet e studimit, ishin në përdorim: 14 salla seminari me nga 35 vende secila, 9 salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet 70 vende, 3 laboratorë informatike me nga 35 vende, 1 sallë interneti me 80 kompjutera dhe 1 bibliotekë me 150 vende leximi. Ndërsa që nga shtatori 2021, në selinë e re në Rugën “Xhanfize Keko”, janë funksionale: 13 salla seminari me një kapacitet total prej 353 vendesh, 15 salla leksionesh me gjithsej 1138 vende, 7 laboratorë informatike me 190 vende dhe 1 sallë interneti me 70 vende. Duke qenë se gjatë viteve 2018-2024 në programin Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale janë regjistruar gjithsej 175 studentë, rezulton se institucioni ka ofruar mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, si në raport me natyrën specifike të studimit dhe moduleve përkatëse, ashtu edhe me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i infrastrukturës rezulton se pajisjet dhe mjediset e institucionit janë të përshtatshme dhe përputhen me kërkesat e procesit mësimor. Në çdo ambient mësimor dhe pune janë të instaluar mjete audiovizuale, kompjuterë, projektorë dhe sisteme zanore, të cilat sigurojnë funksionimin normal të veprimtarisë mësimore. Gjithashtu, të gjitha hapësirat janë të pajisura me sisteme kondicionimi dhe mbulohen nga sinjali Wi-Fi, duke mundësuar aksesin e studentëve në platformat online LMS dhe Microsoft Teams. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Është konstatuar se mjediset e institucionit janë të pajisura me aparaturë dhe mjete të përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të procesit mësimor. Rezulton se institucioni ka mundësuar furnizimin e këtyre mjediseve me kompjuterë, ka siguruar mirëmbajtjen e tyre, si dhe instalimin dhe përditësimin në kohë të programeve nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, është verifikuar se për lehtësimin e programit mësimor janë instaluar programe aplikative të domosdoshme dhe bashkëkohore, të cilat mbështesin studentët dhe pedagogët në zhvillimin e proceseve akademike. <i>E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së	Është konstatuar se për asistimin e studentëve të programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale,

paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	institucioni ka vënë në dispozicion laboratorë të teknologjisë së informacionit. Në funksion të këtij programi është inaguruar salla InnoLab, e pajisur me kompjuterë dhe videoprojektor. Gjithashtu, rezulton se në të gjithë institucionin funksionojnë 7 laboratorë informatike, të pajisur me kompjuterë dhe videoprojektorë. Të gjitha këto hapësira janë të pajisura me paketa programesh profesionale, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të procesit mësimor. E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Spas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e vizitës në institucion, rezulton se praktikat mësimore të programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale zhvillohen në ambientet e institucionit, në salla leksionesh të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e tyre. Ndërkohë, praktikat profesionale organizohen në institucione të ndryshme, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me subjekte të fushës përkatëse. E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. E. 34.1 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Fondacionit "Fundjavë Ndryshe" E. 34.2 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Bashkia Tiranë E. 34.3 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Gazeta Liberale E.34.4 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Albtelecom E.34.5 Memorandum bashkëpunimi mes EEI dhe Balfin E.34.6 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe UET PRESS E.32.1 Dokumenti mbi praktikat profesionale			
Konkluzione	Universiteti European i Tiranës ka krijuar një infrastrukturë moderne dhe të zgjeruar në kampusin e ri, e cila ofron ambiente dhe teknologji bashkëkohore të përshtatshme për zhvillimin e programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet në fuqi. Kapacitetet e përmirësuara hapësinore dhe bashkëpunimet me institucione partnere sigurojnë mbështetje efektive për realizimin e praktikës profesionale dhe për përmbushjen e objektivave të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e Universitetit European të Tiranës, e vënë në shërbim të studentëve, disponon literaturë fizike dhe digjitale të nevojshme për mbështetjen e proceseve mësimore dhe për përvetësimin e dijeve të përditësuara në fushën e Shkencave të Komunikimit. Në vitin akademik 2020-2021, fondi i bibliotekës u pasurua me rreth 1,392 artikuj, ndërsa gjatë viteve akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 u shtuan edhe 1,708 libra në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në lidhje me nevojën për përditësimin e literaturës, njësia përgjegjëse komunikohet me përgjegjësin e Bibliotekës për pasurimin dhe përditësimin e fondit me literaturën e nevojshme, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi normal i procesit mësimor dhe mbështetje për aktivitetet kërkimore shkencore. Përgjegjësi i Bibliotekës regjistron gjithashtu numrin e kopjeve të reja që hyjnë në fond nga Departamenti, duke marrë parasysh botimin, llotin e librave dhe nevojat e kërkesat e studentëve. <i>E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës.</i> <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Salla e Bibliotekës ka një sipërfaqe prej 40 m², ndërsa Salla e Leximit ka një sipërfaqe prej 50 m² dhe ofron 41 vende për lexim. Biblioteka është gjithashtu e pajisur me kompjuterë, të cilët u mundësojnë studentëve akses në bibliotekat online dhe arkivat SAGE dhe EBSCO. <i>E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e	Për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale disponon një fond prej 2,379 librash në gjuhët shqip, anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht. Biblioteka e institucionit ofron kushte optimale për studim dhe punë kërkimore, duke funksionuar me

mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	orar të zgjatur dhe duke ofruar akses në programet dhe abonimet elektronike SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing, ASTM Compass dhe RESEARCH4LIFE. Institucioni ka gjithashtu akses të plotë në pesë platforma elektronike të reja: Edward Elgar Publishing 2, ASTM Compass 2, IOP Science, IOS Science 2 dhe Hein Online's Social Justice Suite. Për të mbështetur nevojat e programeve mësimore, Biblioteka ofron literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj, si dhe botime të UET PRESS, të përzgjedhura për përdorim në syllabuset e lëndëve të programit Master në Komunikim dhe Media Digjitale. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Të gjitha ambientet e institucionit janë të pajisura me lidhje Wi-Fi, që ofron akses të pandërprerë të studentëve në bibliotekën virtuale. Komputerët e vendosur brenda Bibliotekës mundësojnë qasje në platformat SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing, ASTM Compass dhe RESEARCH4LIFE, ku studentët kanë mundësi të konsultojnë mijëra artikuj dhe botime shkencore. Për nevojat e programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale, Biblioteka ka krijuar një katalog elektronik me libra në gjuhë të huaj, duke mbështetur studimet dhe aktivitetin kërkimor të studentëve. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzim pa kufizim për të gjithë studentët, duke siguruar akses në katalogët online dhe librat elektronikë. Aty gjenden gjithashtu kompjuterë në numër të mjaftueshëm për të lehtësuar aksesin e vazhdueshëm në bibliotekën virtuale. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve në gjashtë ditët e javë nga e Hëna në të Premten në oraret 09.00-20.00, ndërsa të Shtunën në orarin 10.00-17.00, në përshtatje me programet e studimit, duke përfshirë edhe programin Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale. Gjatë sezoneve të provimeve ky orar është i zgjatur përtej kohës së zakonshme të shërbimit. <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit raportojnë periodikisht mbi cilësinë e fondit fizik dhe atij online, si dhe mbi

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	gjendjen dhe shfrytëzimin e sallave fizike. Njëkohësisht, ato hartojnë planet dhe kërkesat për pasurimin e fondit me artikuj të rinj, si për literaturën fizike, ashtu edhe për atë online.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatohet se Biblioteka e Universitetit European të Tiranës ofron një strukturë të mirëorganizuar dhe të përditësuar, me fond të pasur librash dhe akses në platformat ndërkombëtare, duke mbështetur në mënyrë efektive studentët e programit Master në Komunikim dhe Media Digjitale. Pajisjet moderne, orari fleksibël dhe bashkëpunimi me njësitë akademike sigurojnë kushte optimale për studim dhe aktivitet kërkimor shkencor. Ky element rezulton i përputhshëm me standardet dhe kërkesat ligjore për funksionimin e bibliotekave akademike</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Të dhënat e studentëve regjistrohen dhe administrohen nga Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore e Institucionit, të cilat mbajnë informacion mbi arritjet akademike, si dhe mbi lëshimin e diplomave dhe certifikatave. Studentët regjistrohen gjithashtu në Sistemin e Menaxhimit të Procesit Mësimor (UMIS), ku ruhen të dhënat personale dhe akademike. Stafi akademik ka akses të plotë në databazën “Dokumena UET”, ndërsa studentët mund të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS. Regjistrimi dhe trajtimi i të dhënave realizohet duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe duke garantuar siguri dhe integritet të informacionit personal. Pedagogët e rinj që punësohen në UET janë të detyruar të ndjekin seanca metodologjike për përdorimin e UMIS-it, për të cilin institucioni siguron stafin mbështetës dhe manualin e përdorimit. <i>E. E.1 Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i> <i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 16 A.II. Kodi i Etikës UET</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Secila zyrë e stafit akademik të UET është e pajisur me kompjuterë, ku gjendet databaza e institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”. Përmes kësaj databaze, secili pedagog mund të aksesojë në kohë reale të dhënat që lidhen me strategjitë, rregulloret, urdhrat administrativë, standardet dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm. Përveç kësaj, sistemi UET LMS përdoret për të mbajtur kontakt me studentët lidhur me materialet e leksioneve dhe seminareve, veprimtaritë mësimore, detyrat e kursit, esetë, tezat e provimit dhe rezultatet e vlerësimit. Komunikimi me studentët mundësohet gjithashtu përmes mjeteve elektronike si email, forum dhe chat. <i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët kanë mundësi të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe mbi lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS, ku regjistrohen për secilën lëndë, ndërsa personeli i Universitetit ka qasje të plotë në databazën e institucionit të quajtur “Dokumenta UET”. <i>E. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	Zyra e Regjistrimit të studentëve regjiston dhe administron të dhënat e studentëve si dhe Sekretaria Mësimore e Institucionit, të cilat mbajnë informacion mbi arritjet akademike, si dhe mbi lëshimin e diplomave dhe certifikatave. Studentët regjistrohen gjithashtu në Sistemin e Menaxhimit të Procesit Mësimor

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	(UMIS), ku ruhen të dhënat personale dhe akademike. Stafit akademik ka akses të plotë në databazën e institucionit “Dokumena UET”, ndërsa studentët mund të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS. Platforma Microsoft TEAMS u aktivizua gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, për zhvillimin e mësimin online dhe organizimin e takimeve të klubeve studentore. Aktualisht, kjo platformë vazhdon të përdoret për takime me të ftuar të ndryshëm, si dhe për realizimin e aktiviteteve të tjera mësimore dhe jashtëmësimore në distance. <i>E. 56.1. Kalendari i aktiviteteve të departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit</i> <i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Institucioni monitoron aktivizimin e çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS (Learning Management System) për lëndët dhe grupet përkatëse, si dhe në Microsoft TEAMS, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të shërbimit ndaj studentëve. Në fund të çdo semestri, personi përgjegjës për menaxhimin e platformës UET LMS harton dhe dërgon Raportin mbi zhvillimin e mësimin online dhe aktivitetin e pedagogut në platforma, duke mundësuar raportime individuale dhe akses në të dhëna në kohë reale për drejtuesit dhe titullarët. <i>E.46.5 Raport: Ecuria e mësimin online</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e UET, në gjuhën shqipe dhe angleze, ofron informacion të plotë mbi programet e studimit të institucionit, të dhënat për personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse, kualifikimet dhe CV-të e stafit akademik, si dhe aktivitetet kërkimore shkencore, leksionet e hapura dhe me personalitete të ftuar, projektet dhe njoftimet përkatëse. <i>E. 47 Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>Sistemi i institucionit për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe të procesit mësimor është i strukturuar dhe siguron siguri dhe konfidencialitet përmes platformave UMIS, UET LMS dhe Microsoft Teams. Komunikimi akademik dhe monitorimi i aktivitetit të pedagogëve realizohen në mënyrë efektive. Studentët marrin informacion në kohë reale për programet dhe detyrat e tyre, duke përmbushur standardet e kërkuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Burimet financiare dhe menaxhimi i tyre përbëjnë element kyç për funksionimin e procesit mësimor. Institucioni harton çdo muaj raport të detajuar mbi të ardhurat dhe shpenzimet, duke u bazuar në buxhetin e miratuar dhe duke identifikuar fondet rezervë për shpenzimet me prioritet. Tarifat e shkollimit, kontributi nga grantet kërkimore, projektet e ndryshme dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbëjnë burimet kryesore të financimit të UET. Shpenzimet e buxhetit përfshijnë pagesat për personelin akademik, mbështetjen e studentëve dhe mirëmbajtjen e mjediseve të institucionit. Raporti vjetor i auditimit përfshin gjithashtu analizën e kostove për çdo program, ndërsa të dhënat financiare përdoren për të përcaktuar strategjitë institucionale me qëllim përmirësimin e performancës dhe të cilësisë së mësimdhënies. <i>E. 49 Të dhëna mbi koston për student</i> <i>E. 50. Të ardhura financiare dhe të ndryshme</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online dhe tregimet	Institucioni harton planin e financimit të programit të studimit në përputhje me standardet e hartimit dhe raportimit financiar. Plani përfshin financimin e burimeve njerëzore të dedikuara për realizimin e programit. Plani mbulon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe të teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, si dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës. Plani siguron aksesin në bibliotekat online, mbulon detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programit mësimor dhe përfshin zëra të tjerë të përshtatur sipas specifikave të programit. <i>E. 50. Të ardhura financiare dhe të ndryshme.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin	Auditimi i brendshëm i Universitetit Europian të Tiranës kryhet çdo vit nga njësitë përkatëse të institucionit. Auditimi i jashtëm realizohet nga auditues të emëruar nga Ministria e Arsimit. Shoqëria E.E.I. Sh.p.k., e licencuar për ekspertizë financiare, harton çdo vit raport mbi transparencën e

financiar të tij.	financave të institucionit. Audituesi i pavarur ligjor ofron opinion mbi gjendjen financiare dhe përputhshmërinë me standardet kontabël. Pasqyrat financiare paraqiten sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe tregojnë saktë gjendjen financiare dhe performancën vjetore të institucionit. Auditimi i jashtëm, i zhvilluar pas mbylljes së pasqyrave, bazohet në analizën e të dhënave financiare dhe përfundon me raport që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. <i>E. 50.1 Pasqyrat financiare.</i> <i>E. 2. Statuti UET</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni paraqet gjendjen financiare për programin e studimit çdo fillimviti pranë njësisë përgjegjëse. <i>E. 2. Statuti UET.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në muajin tetor të çdo viti, institucioni harton buxhetin financiar. Nga aksionerët e institucionit miratohet buxheti. Për zbatimin e tij janë përgjegjës Administratori dhe Zyra e Financës. Ekuilibri mujor ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve sigurohet nga projekt-buxheti. Gjatë zhvillimit të programit të studimit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe disponon kapacitete për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave. Vendime menaxheriale për stabilitetin dhe vazhdimësinë e programeve të studimit mundësohen nga analizat e efikasitetit dhe kostove, së bashku me auditimet e brendshme dhe të jashtme. <i>E.50. 1 Pasqyrat financiare 2019</i> <i>E.50. 2 Pasqyrat financiare 2020</i> <i>E.50. 3 Pasqyrat financiare 2021</i> <i>E.50. 4 Raporti i auditimit 2018</i> <i>E.50. 5 Raporti i auditimit 2019</i> <i>E.50. 6 Raporti i auditimit 2020</i> <i>E. 2. Statuti UET.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni siguron menaxhim dhe financim të qëndrueshëm të burimeve financiare për të garantuar cilësinë e procesit mësimor. Buxhetet vjetore përgatiten nga institucioni dhe miratohen, ndërsa të ardhurat dhe shpenzimet monitorohen me rigorozitet. Financimi mbështetet kryesisht nga tarifat e studentëve, grantet dhe donatorët. Pasqyrat financiare hartohen sipas standardeve kombëtare dhe auditohen brenda dhe jashtë. Plani financiar për secilin program siguron transparencë dhe qëndrueshmëri në përdorimin e burimeve njerëzore, infrastrukturës dhe teknologjisë.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politikat dhe procedurat e gjera për programin Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale " janë krijuar dhe vënë në zbatim nga institucioni për ciklin e dytë të studimeve universitare, duke garantuar respektimin e ligjeve përkatëse. Këto politika përshkruhen në Statut dhe Rregulloren përkatëse të Studimeve Universitare. Gjatë një viti akademik, 60 kreditet e programit janë të shpërndara për t'u siguruar studentëve njohuri të gjithanshme profesionale në fushën e komunikimit. Shqipja është gjuha e programit. Në faqen zyrtare të institucionit, në broshurën UET Guidë, në mediat informative dhe gjatë seancave të këshillimit publikohen kërkesat e pranimit dhe procedurat e aplikimit, për të garantuar transparencë dhe akses të përshtatshëm në informacion. Progresi i studentëve monitorohet nga afër gjatë gjithë procesit arsimor nga institucioni, duke zbatuar politika dhe procedura të përcaktuara për mbështetjen e zhvillimit akademik dhe profesional. <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i> <i>E. 2. Statuti UET</i> <i>E. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i> <i>E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i>

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Barazi e plotë dhe të njëjtat përfitime garantohen për të gjithë kandidatët dhe studentët e regjistruar në programin Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale që nga momenti i pranimit deri në diplomim. <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale"</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në programet e studimit që ofron UET-i lejohen të regjistrohen shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga organet drejtuese të institucionit, në bashkëpunim me mekanizmat për kryerjen e maturës shtetërore, në përputhje me rregulloret e programit dhe ligjet në fuqi. Kërkesa shtesë për pranimin mund të vendosen nga departamenti për të zgjedhur aplikantët; këto bëhen të ditura në UET dhe i raportohen ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Parimet, kërkesat dhe hapat specifikë për pranimin e studentëve përcaktohen në një dokument të veçantë, i postuar në faqen zyrtare të UET-it. <i>E. 5. Rregullore UET</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Informacioni i plotë dhe i përditësuar mbi programin e studimit "Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale", përfshirë kriteret pranimi, mundësi bursash dhe procedurat e aplikimit, gjendet në faqen zyrtare të universitetit përkatës dhe është i aksesueshëm për studentët. Studentët mund të konsultojnë gjithashtu informacion të detajuar mbi kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes, përparimin gjatë studimeve, mundësitë e transferimit të krediteve, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin. <i>Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informacion i qartë dhe i detajuar mbi programet e studimit, përfshirë Masterin Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale, ofrohet nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) për maturantët dhe të interesuarit. Ky informacion është i disponueshëm përmes kanaleve të ndryshme komunikimi, si faqja zyrtare e internetit, mbështetja nga këshilluesit e karrierës, zyra e pranimeve, takime të drejtpërdrejta me studentë potencialë dhe aktivitete si "Gjimnaz Tour". Në këto aktivitete, maturantët njihen nga afër me programet akademike, kushtet e pranimit dhe shërbimet për studentët, gjë që i ndihmon ata të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të ndërgjegjshme për të ardhmen e tyre akademike. <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe</i>

	<i>Kujdesit ndaj Studentit</i> E. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Përveç kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni, institucioni nuk vendos kërkesa shtesë për pranimin në programin “Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale”. Politikat, kriteret dhe procedurat e pranimi të studentëve janë të pasqyruara në Dokumentin D.I. Çdo vit akademik, institucioni përcakton kuota të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara, si dhe për ata që i përkasin pakicave apo shtresave të marginalizuara E. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Transferimet e studentëve në vitet ndërmjetëse pranohen nga UET-i nga universitete të tjera, qofshin ato vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Ndërkohë, UET-i lejon edhe transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera, sipas procedurave të miratuara me dokument të veçantë. Studenti duhet të ndjekë së paku një vit akademik në UET dhe të fitojë të paktën 25% të ECTS-ve për lëndët e kategorive A-D, duke përmbyshur gjithashtu detyrimet përfundimtare të programit të studimit. E. 5. Rregullore UET
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bursa të plota ose të pjesshme për studim ofrohen nga UET-i, duke u bazuar në kritere të caktuara përzgjedhjeje, me qëllim nxitjen e rezultateve të larta akademike dhe mbështetjen sociale të grupeve të diskriminuara ose në nevojë. Zbritje në tarifat e shkollimit ofrohen gjithashtu për aplikantët ose studentët me rezultate të shkëlqyera, për ata që i përkasin të njëjtës familje, dhe politika ndihmëse/bursash zbatohet për individët në nevojë. Këto masa kontribuojnë në rritjen e cilësisë së pranimi në programet prioritare të institucionit dhe mbështetjen zhvillimin ekonomik të vendit. E. 5. Rregullore UET E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale”
Konkluzione	<i>Politikat transparente dhe të përputhshme me ligjin për ciklin e studimeve të programit “Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale” janë zhvilluar dhe zbatohen nga institucioni, duke garantuar akses të barabartë për kandidatët dhe informacion të qartë mbi pranimin, bursat dhe përparimin akademik.</i> <i>Përfshirja dhe ekselencia në arsimin e lartë nxitën gjithashtu aktivitetet promovuese dhe mbështetja sociale, përfshirë bursa</i>

	dhe lehtësi tarifore. Transferimet nga universitete të tjera pranohen sipas kriterëve të përcaktuara, duke plotësuar masat për një proces të drejtë dhe transparent			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit për karrierën dhe sekretarisë, institucioni vendos në dispozicion informacion të plotë dhe të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve, si dhe për mundësinë e shtyrjes së vitit akademik në një periudhë tjetër. 2023-2024 janë rregjistruar për herë të parë 2 studente në Marrëdhënie Publike 2024-2025 janë rregjistruar për herë të parë 2 studente në Marrëdhënie Publike dhe 3 studentë në Marketing <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen nga institucioni mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesshme. Transferimet e studentëve në vitet ndërmjetëse pranohen nga UET-i nga shkolla të tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, ndërsa studenti i UET-it mund të transferohet në institucione të tjera. Procedura e transferimit, që përfshin dorëzimin e kërkesës me shkrim nga studenti, njohjen e lëndëve dhe regjistrimin në programin e studimit, është e përcaktuar në Dokumentin D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin". <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i> <i>E. 5. Rregullore UET.</i> <i>E. 28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Mënyra e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse përcaktohet qartë në rregulloren e programit të studimit, duke u bazuar në

me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	tipologjinë e lëndëve. Studenti merr gjithashtu këtë informacion nga syllabusi i lëndëve. Si përfundim, konstatohet se institucioni siguron informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i> <i>E. 19 Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin Master Shkencoe në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Plani i diplomimit përcaktohet në mënyrë të detajuar në dokumentin për punimin e diplomës, duke përfshirë aplikimin për temë, miratimin e saj, zgjedhjen e pedagogut udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, si dhe formatimin, dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit. Fazat kohore për dorëzimin dhe mbrojtjen e diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik, ndërsa studentët njoftohen gjithashtu nga koordinatorët e Departamenteve përmes emailit për çdo veprimtari akademike. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i> <i>E. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i> <i>E. 10.5. Kalendari akademik</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni informon të interesuarit mbi programin e studimit para fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike. Studentët e ardhshëm kanë mundësinë të njohin nga afër ambientet, pedagogët dhe procesin e mësimdhënies gjatë Ditëve të Hapura, të organizuara për çdo fakultet. <i>E. 5. Rregullore e UET</i>
Konkluzione	<i>Informacion i qartë dhe i aksesueshëm mbi përparimin akademik, njohjen e krediteve, transferimet dhe vlerësimin e dijeve sigurohet nga institucioni për studentët, duke garantuar transparencë përmes dokumenteve zyrtare dhe komunikimit institucional. Procesi i diplomimit është i strukturuar mirë dhe shoqërohet me aktivitete promovuese për orientimin e studentëve të rinj, ndërsa mbështetja e vazhdueshme ofrohet gjatë gjithë ciklit studimor të programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informacion i detajuar mbi strukturën dhe kohëzgjatjen e programit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale jepet në rregulloren përkatëse të programit, e cila publikohet në fillim të çdo viti akademik. Qysh nga momenti i aplikimit dhe regjistrimit, si dhe gjatë zhvillimit të programit, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit nga Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe pedagogët. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm përmes platformës UET LMS, ku çdo student mund ta konsultojë. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i> <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Grupet e pedagogëve të UET vizitojnë shkollat të mesme në qytete të ndryshme të vendit (Gjimnaz Tour), duke prezantuar maturantëve programet e studimit, kushtet dhe shërbimet që ofrohen për studentët, në mënyrë që ata të marrin vendime të informuara dhe të ndërgjegjshme. Maturantët mund të ndjekin gjithashtu "Open Days", ku vizitojnë institucionin dhe marrin pjesë në orë të caktuara mësimi, ndërsa studentët e rinj orientohen gjatë Javës së Orientimit përpara fillimit të vitit akademik. Tutoriati u ofrohet studentëve të ciklit të parë për të mbështetur identifikimin dhe arritjen e qëllimeve akademike, ndërsa këshillimi akademik ndihmon në zgjidhjen e çdo vështirësie që mund të lindë gjatë përmbyshjes së detyrimeve të lëndëve. Informacioni dhe dokumentacioni mbi përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese të lëndëve dhe moduleve janë të disponueshme për studentët në zyrën e sekretarisë dhe koordinatoreve, në UET LMS dhe në faqen zyrtare të institucionit. Në fillim të çdo semestri, syllabuset e lëndëve u japin studentëve në formë të shkruar dhe elektronike.

	<i>E. 10. Rregullore e UET</i> <i>E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i> <i>E. 46.1 UET LMS Guidë për studentët</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët në lidhje me karrierën e tyre, duke përfshirë: a. Trajnime online dhe offline për hartimin e CV-së, letrës së motivimit dhe korrespondencës me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave, përfshirë edhe letrat e falenderimit dhe ato të refuzimit të pozicioneve. b. Këshillim për fazat e intervistës së punës dhe përgatitjen për të. c. Prezantimin e kalendarit të eventeve të lidhura me industrinë, përfshirë Open Days për çdo fakultet dhe panairët e punës. d. Zhvillimin e sondazheve të planit të karrierës së studentëve, për të kuptuar burimet e punësimit, mundësitë e internship-eve dhe planet e karrierës. e. Mentorim dhe ndërtim rrjeti (networking) përmes të gjitha burimeve dhe partneriteteve të universitetit, përfshirë Alumni, bordet e tregut të punës, grupet e studentëve në LinkedIn, si dhe rrjetin e studentëve që kanë kryer internship ose Erasmus. Në këtë mënyrë, studentët përfitojnë një orientim të plotë akademik dhe profesional, duke u përgatitur për tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës. <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët marrin informacion të plotë dhe të qartë mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin realizimin e tij. Sekretaria, koordinatoret, Zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, si dhe platforma online UET LMS, sigurojnë akses në materialet e programit dhe mundësinë e shkëmbimit të informacionit me pedagogët dhe studentët e tjerë. Procesi i tutoratit dhe këshillimit akademik, i shpallur që në fillim të vitit akademik, përfshin seanca të dedikuara për të ndihmuar studentët në zgjedhjen dhe përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit, monitorimin e përmbushjes së krediteve për kalimin në vitin pasardhës dhe motivimin për të arritur rezultate të larta akademike. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale"</i> <i>E. 27.2 Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të	Informacioni mbi procesin mësimor është i aksesueshëm lehtësisht përmes faqes së internetit të Fakultetit dhe platformës UET LMS. Secili student disponon një llogari personale në LMS, e cila i mundëson të marrë shërbime të ndryshme dhe të ketë qasje në informacionin e nevojshëm edhe në distancë. Ky sistem

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	siguron pavarësi, lehtësi në përdorim dhe rrit transparencën në marrjen e shërbimeve akademike. <i>E. 46.1 UET LMS Guidë për studentët</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i ekspertëve vlerëson se programi Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale ofrohet dhe zbatohet në mënyrë transparente, duke siguruar studentëve qasje të lehtë dhe të qartë në informacion. Mbështetja për studentët, përmes aktiviteteve promovuese, tutorimit, këshillimit akademik dhe ndihmës për karrierën, tregon një angazhim të plotë për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni mbledh dhe mban statistika vjetore mbi studentët e diplomuar në programin Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale. Përmes Zyrës së Zhvillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni, institucioni ruan kontakte të vazhdueshme me ish-studentët, jo vetëm për të ndarë eksperiencat dhe arritjet e tyre profesionale, por edhe për të krijuar lidhje efektive midis universitetit dhe tregut të punës. <i>E. 29 Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve</i> <i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve</i> <i>. 55.3 Kalendari i aktiviteteve të planifikuara të Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi,	Institucioni mbledh dhe ruan statistika vjetore mbi studentët e regjistruar në programet Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të tij, si dhe rastet e mospërfundimit me sukses të vitit akademik përkatës. <i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>

si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistike të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm UMIS, ku ruajtja dhe verifikimi kryhen në mënyrë të sigurt nga personat e autorizuar, si stafi IT dhe sekretaria mësimore. Për mbështetje shtesë, përdoret edhe sistemi UET LMS. <i>E. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 9. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Çdo student ka një dosje personale që përmban të gjitha të dhënat, nga momenti i regjistrimit deri pas diplomimit. Këto informacione ruhen në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) administron dhe përpunon të gjitha të dhënat akademike të studentëve, si dhe prodhon raportet statistikore të nevojshme. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në UET përgatiten raporte analitike periodike që pasqyrojnë profilin dhe cilësinë e studentëve në momentin e hyrjes dhe të daljes, si dhe nivelin e punësimit të tyre. Të dhënat e mbledhura përdoren për të marrë masa të duhura që synojnë përmirësimin e këtyre treguesve. <i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i> <i>E. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të MSHSHK</i> <i>E. 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>
Konkluzione	<i>Gjatë gjithë ciklit studimor, institucioni mbledh dhe menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes platformave UMIS dhe UET LMS. Për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e programit, përdoren raportet analitike periodike mbi</i>

	hyrjen, daljen dhe punësimin e studentëve, ndërsa lidhja me ish-studentët realizohet aktivisht përmes Zyrës së Zhvillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni, si dhe raportet analitike periodike mbi hyrjen, daljen dhe punësimin, tregojnë një angazhim proaktiv për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas Rregullores së UET, studenti përfshihet në mënyrë të qartë në strukturat vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Përfshirja dhe angazhimi i tyre realizohet përmes Këshillit Studentor, fokus-grupeve të vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, si dhe vlerësimeve online të pedagogut. Për më tepër, studentët marrin pjesë në Senatin Akademik të UET, Dekanat, Këshillin e Etikës dhe Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas rregullave ligjore dhe rregullatore të universitetit. <i>E. 5. Rregullore e UET</i> <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni siguron që studentët të jenë të përfshirë në vendimmarrje dhe aktivitete të matshme e të verifikueshme, përfshirë pjesëmarrjen në Këshillin e Studentëve, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik, si dhe vlerësimin e pedagogëve që japin mësim. Të dhënat mbi këtë përfshirje administrohen dhe ruhen nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. <i>E. 5. Rregullore e UET</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse	Studentët përfshihen në mënyrë aktive në hartimin, rishikimin

garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	dhe përmirësimin e programeve të studimit, duke marrë pjesë periodikisht në mbledhjet e hapura të departamentit dhe në fokus grupet e ndryshme, ku mund të japin sugjerime. Përveç kësaj, ata kanë mundësinë të japin mendimet e tyre online në çdo kohë përmes UET LMS dhe Microsoft TEAMS, duke komunikuar drejtpërdrejt me departamentin përkatës. <i>E. 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe të Departamentit.</i> <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale"</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u sigurohet mundësia për të dhënë mendimet e tyre mbi barazinë dhe drejtësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve; pedagogu përgjegjës mund të ofrojë rishikim dhe diskutim mbi rezultatet, përfshirë edhe mundësinë e ankimit. Provimet kryhen në mënyrë të sekretuar, duke garantuar anonimitetin e plotë të studentit. Transparente janë gjithashtu vlerësimet e rubrikave të tjera, dhe pas çdo provimi organizohen seanca sqaruese ku studentët komunikojnë me pedagogun përkatës për rezultatet dhe opsionin e rishikimit. Kur ndodh ankimi, një komision AD-HOC i ngritur në nivel Departamenti ose Fakulteti përcakton vlerësimin, duke respektuar plotësisht procedurat transparente. <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Komunikim dhe Media Digjitale".</i>			
Konkluzione	<i>Vlerësojmë, si grup ekspertësh të jashtëm, se Universiteti European i Tiranës ka vendosur mekanizma dhe politika efektive që garantojnë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe proceset akademike në mënyrë aktive dhe të matshme, përfshirë pjesëmarrjen në Këshillin Studentor, Senatin Akademik dhe komisionet e ndryshme. Sistemi i vlerësimit akademik, duke respektuar anonimitetin dhe të drejtat e studentëve, funksionon në mënyrë transparente, ndërsa mundësitë për ankim dhe rishikim forcojnë bashkëpunimin dhe dialogun midis studentëve dhe stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin,

këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Për studentët e programit, UET ka vendosur njësi dhe procedura të specializuara që sigurojnë shërbim dhe informim në përputhje me ligjet dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Informacioni dhe dokumentacioni i detajuar mbi lëndët/modulet, përmbajtjen, aktivitetet formuese dhe gjithë procesin akademik është i aksesueshëm në zyrën e sekretarisë, te koordinatorët, në UET LMS dhe në faqen zyrtare të institucionit. Javën e orientimit akademik, që organizohet në fillim të çdo semestri, studentët marrin silabuset dhe informacionet e tjera të nevojshme në formë të shkruar dhe elektronike. Një rol të veçantë në këtë proces ka Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>E. 46.2. Guidë për studentët</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Për studentët, UET ka vendosur një sistem të posaçëm informimi, këshillimi, ndjekjeje dhe asistence përmes Zyrës së Pranimeve. Mbështetja e studentëve për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit sigurohet edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, këshilluesit akademikë, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve dhe regjistruarit e lëndëve. Informacioni dhe asistenca ofrohen kryesisht përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe njësive të tjera, si dhe në platformat UET LMS dhe Microsoft TEAMS, ku studentët mund të marrin të dhëna të përditësuara mbi procesin mësimor dhe programin e studimit. Përveç kësaj, informimi realizohet edhe përmes emailit dhe publikimeve pranë këndit të njoftimeve, duke garantuar qasje të vazhdueshme dhe këshillim nga individët dhe njësitë përgjegjëse. <i>E. 9. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ofron vazhdimisht orientim dhe informacion të detajuar për studentët, duke përfshirë këshillimin për karrierën, udhëzime mbi kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera, si dhe informacion mbi mundësitë dhe kërkesat e tregut të punës. <i>E. 27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i> <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i>

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, së bashku me Shoqatën Alumni, ndjek pas diplomimit studentët e programit të studimit, duke mbledhur, përpunuar dhe ruajtur të dhëna mbi punësimin e tyre. Këto të dhëna vihen në dispozicion të studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Për më tepër, zyra ndërmerr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit përmes bashkëpunimit me organizatat partnere të UET, dhe feedback-u mbi këto aktivitete i komunikohet veçmas studentëve dhe organeve drejtuese të universitetit. <i>E. 29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve.</i> <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve.</i>			
Konkluzione	<i>Njësitë e specializuara dhe platformat elektronike, përfshirë UET LMS dhe Microsoft Teams, përdoren nga Universiteti Europian i Tiranës për të ofruar mbështetje dhe informim të vazhdueshëm për studentët gjatë gjithë ciklit akademik. Pas diplomimit, institucioni monitoron punësimin e studentëve në bashkëpunim me Shoqatën Alumni dhe partnerë të ndryshëm, duke përmirësuar lidhjet me tregun e punës dhe cilësinë e shërbimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Si prioritet thelbësor, institucioni ka vendosur trajnimin e personelit akademik për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies, duke e konsideruar këtë një investim dhe domosdoshmëri për zhvillimin e burimeve njerëzore. Krahas trajnimit, angazhimi i stafit akademik në punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike parashikohet si alternativë për pasurimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, çka i mundëson ndjekjen e zhvillimeve të fundit në fushën përkatëse. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, realizon identifikimin e nevojave për kualifikime përditësuese. Për më tepër, institucioni ka krijuar një sistem për menaxhimin e performancës së personelit akademik, i cili thjeshtëson identifikimin e atyre që përdorin metoda të vjetra mësimdhënieje dhe që kanë nevojë për kualifikime përditësuese. Vlerësimi përmes follow-up, fokus-grupesh, orëve mësimore dhe raportimit mbi përdorimin e platformës LMS për mësimdhënien përfshihet gjithashtu në këtë sistem. <i>E. 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025.</i> <i>E. 33. Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i> <i>E. 41 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>E. 37 Formimi i relacionit për monitorimin e silabuseve</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Periodikisht, personeli akademik dhe ndihmës-akademik në institucion nënshtrohet trajnimeve, testimeve dhe vlerësimeve nga strukturat përgjegjëse, me qëllim vlerësimin dhe identifikimin e aftësive inovative dhe mësimdhënëse. Në këtë mënyrë nxitet dëshira dhe prirja e personelit për të sjellë risitë dhe përparimin në përcjelljen e dijes tek studentët. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies përfshijnë: - Në auditor, vlerësimi i mësimdhënësit kryhet kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorive “Lektor” dhe “Asistent-lektor”, nga Dekanati, përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësi i grup lëndësh. - Nga studentët, vlerësimi i pedagogut dhe lëndës bëhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimat, përmes fokus-grupesh dhe opinioneve të shprehura në mbledhjet e hapura të departamentit. - Rezultatet e raporteve i përgatit KSBC, e cila është drejtpërdrejt përgjegjëse për mbarrëvajtjen dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

	Aktivitetet kryhen periodikisht sipas planit të veprimit për sigurimin e cilësisë dhe metodologjisë përkatëse, dhe relacionet përkatëse dërgohen Rektoratit dhe/ose Departamenteve. - Nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i ngritur nga Rektori, bëhet vlerësimi (follow-up). <i>E. 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025</i> <i>E. 2 Statuti UET</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 33. Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i> <i>E. 30.13 Metodologjia e punës së KSBC</i> <i>E. 40 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>E. 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteteve të KSBC</i> <i>E. 30.1 Plani i veprimit të KSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët përfshihen nga UET në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, duke pasur të drejtën për të vlerësuar pedagogun dhe cilësinë e orës së mësimi. Ky vlerësim realizohet përmes formularëve/pyetësorëve anonimë nga studentët, të organizuar dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet, ciklet, lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohet dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si dhe secilit pedagog në mënyrë të personalizuar. Studentët gjithashtu kanë mundësinë për të trajtuar ankimime nëpërmjet mbledhjeve mujore të përbashkëta me stafin akademik, ku diskutohen problematikat e mundshme gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Për vlerësimin individual të studentëve, brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit zhvillohen seanca sqaruese, dhe vetëm në rast pakënaqësie pas këtyre seancave, studenti drejtohet te Përgjegjësi i Departamentit për rivlerësim, sipas nenit 32 të Rregullores së UET. <i>E. 40 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 40.1. Formular për ankesat e studentëve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri, strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të përfuturara. Një nga format e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies dhe dijeve realizohet përmes vlerësimit të pedagogut nga studentët. Pas çdo monitorimi hartohet një raport individual dhe një raport i përgjithshëm për secilin pedagog, ku ai informohet mbi rezultatet e marra nga vlerësimi i studentëve. Departamenti analizon këto rezultate, verifikon besueshmërinë e tyre dhe merr masat e nevojshme për përmirësim. Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC ose nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si dhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit.

	<i>E. 2 Statuti UET</i> <i>E. 40 Formati i vlerësimit të padagogut nga studentët</i> <i>E. 5. Rregullore UET.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të tij specifike, promovon shembuj praktikash të mira dhe frytdhënëse për monitorimin e vlerësimit dhe rezultateve të marra, të cilat inkurajojnë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në mbledhjet e departamentit, diskutohen të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mësimdhënies, duke nxjerrë në pah shembuj pozitivë dhe duke nxitur avancimin e praktikave mësimore. <i>E. 5. Rregullore UET</i>			
Konkluzione	<i>Në institucion funksionon një sistem i strukturuar për trajnimin, vlerësimin dhe monitorimin e personelit akademik, i cili siguron përmirësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe përfshirjen transparente të studentëve në procesin e vlerësimit. Rezultatet analizohen dhe diskutohen rregullisht në nivel departamenti, duke nxitur praktikën e mira dhe identifikuar masat e nevojshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore	Institucioni ka ndërtuar politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin shqiptar, VKM-të përkatëse dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Në planin strategjik të universitetit, sigurimi i cilësisë trajtohet si prioritet themelor për rritjen e reputacionit të institucionit brenda dhe jashtë vendit. Në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës dhe standardet evropiane për sigurimin e cilësisë, UET ka përcaktuar politika dhe procedura që mbulojnë

institucionale.	monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, vlerësimin e studentëve, sigurinë e stafit akademik, burimet mësimore dhe shërbimet për studentët, si dhe sistemet informative. Strukturat institucionale për implementimin e SBC përfshijnë: • Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), përgjegjëse për koordinimin e sistemit; • Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti dhe universiteti; • Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Kurrikulave; • Përfaqësues të studentëve dhe anëtarë të përzgjedhur nga Asambleja e Personelit Akademik në komisione. Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë specifikon procedurat, proceset dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e programeve, mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve. Kjo strukturë dhe sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë janë në përputhje me nenin 11 të Statutit të UET dhe sigurojnë funksionimin efektiv të mekanizmave institucionalë të cilësisë. <i>E. 3.3 Plani Strategjik 2021-2025</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i> <i>E. 5 Rregullore e UET</i> <i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UET ka ngritur Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i cili funksionon sipas Statutit të universitetit, Rregullores së institucionit, Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë dhe Manualit për Sigurimin e Cilësisë. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces, duke qenë pjesë e KSBC, duke marrë pjesë në fokus-grupe, në vlerësime online përmes platformës UET LMS, dhe duke komunikuar në çdo moment me stafin e UET. Ata kanë gjithashtu mundësinë për të paraqitur ankime dhe sugjerime për procesin mësimor. Përfshirja e studentëve realizohet edhe përmes formularëve të posaçëm, të cilët i lejojnë ata të vlerësojnë qartësinë e shpjegimeve të pedagogut, interesin që ai nxit në lëndë dhe aftësinë për të stimulur mendimin kritik. Sipas pikës 5.4 të Strategjisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Kreu V: Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë), KSBC përbëhet nga: Kryetari i Komisionit, dy përfaqësues lektorë nga secili fakultet, një përfaqësues nga stafi administrativ, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe të paktën



	një ekspert i jashtëm. Në Strategjinë 2023-2028, pika 3.1 mbi “Organe, autoritet dhe struktura në nivel institucional” përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e KSBC, duke përfshirë bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm. Përfshirja e këtyre ekspertëve është thelbësore për garantimin e objektivitetit dhe paanshmërisë, si dhe për të sjellë perspektiva të reja dhe përmirësime në praktikat e implementuara brenda institucionit. <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në Arsimin e Lartë në UET realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm për akreditim, analizave krahasuese dhe raporteve të ndryshme, përfshirë ato të RVJ pranë KSBC, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programeve dhe funksionimit të institucionit. UET u hap për herë të parë me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe u akreditua për herë të parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 246, datë 24.07.2009. Gjatë vitit 2017, UET i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditim institucional dhe ka marrë vlerësim pozitiv, i shoqëruar me disa rekomandime nga Bordi i Akreditimit, konkretisht me Vendimin Nr. 12, datë 07.04.2017. Ky akreditim institucional kishte një afat prej 5 vitesh dhe përfundoi më 06.04.2022. Gjithashtu, UET ka marrë akreditim nga QAA, i cili mbetet i vlefshëm deri më 11 dhjetor 2027. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale i UET u riorganizua sipas Vendimit nr. 7, datë 14.06.2018 të Senatit Akademik të universitetit. Në kuadër të këtij riorganizimi, UET iu nënshtrua akreditimit institucional pas ristrukturimit të disa fakulteteve ekzistuese dhe hapjes së dy fakulteteve të reja, dhe vendimi i akreditimit u miratua me VBA nr. 46, datë 05.07.2019. Për të adresuar rekomandimet e marra, UET përfshiu në programin e masave veprime për përmirësimin e administrimit të viteve akademike dhe plotësimin e këtyre sugjerimeve. Në dhjetor 2022, institucioni mori vlerësim pozitiv për akreditimin institucional nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (AAQ) për një periudhë 5-vjeçare. <i>E. 54.1 VKM nr 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”</i> <i>E. 54.3 UMAS nr. 246, datë 24.07.2006 “ Për akreditimin institucional të UET”</i> <i>E. 54.2 Vendimi i Senatit të UET nr. 7 datë 14.06.2018 “Për miratimin e riorganizimit dhe përshtatjes së programeve të ciklit</i>



	<i>të parë dhe të dytë të studimit”.</i> E. 54.8.2 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin institucional të UET”.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	UET përdor metodologji dhe instrumente të ndryshme për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues, të organizuara nga KSBC, mbulojnë të gjitha proceset akademike gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raportohet pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve përkatëse. Përveç kësaj, KSBC jep rekomandime dhe përcakton detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga strukturat drejtuese dhe nga vetë komisioni përgjegjës. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe bëhen të njohura për autoritetet përgjegjëse, si titullari i lëndës, përgjegjësit e grup-lëndëve, përgjegjësi të departamentit dhe strukturat e tjera drejtuese. E. 30.5 Metodologjia e punës së KSHC E. 37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve			
Konkluzione	<i>Sistemin e organizuar dhe funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë UET e ka krijuar dhe zbatuar, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë. Aktiv dhe i përfshirë në këtë proces është studentët dhe ekspertët e jashtëm, ndërsa proceset e monitorimit dhe raportimit kryhen në mënyrë të rregullt dhe transparente. Kjo tregon përkushtimin e institucionit ndaj përmirësimit të vazhdueshëm dhe forcimit të reputacionit të programeve akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor	Raportet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit përgatiten dhe shpërndahen nga UET në

mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	formë dokumenti, i cili u vihet në dispozicion pedagogëve, strukturave drejtuese dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto vlerësime diskutohen dhe prezantohen si në nivel Rektorati, ashtu edhe në nivel departamenti. <i>E. 30.6 Format raporti për provimet</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, konkluzionet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Në lidhje me kontrollet e zhvillimit të provimeve, qofshin ato përfundimtare apo të ndërmjetme, seksioni i parë i raportit evidenton gjetjet dhe problematikat, duke përfshirë lëndën dhe pedagogun përkatës, ndërsa seksioni i dytë ofron një analizë më të detajuar të këtyre çështjeve. Ky komponent siguron dokumentimin e rezultateve të vlerësimit, ndërsa përshkrimi i metodologjisë së punës së KSBC tregon rezultatet e pritshme duke u bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara. Analizat vjetore në nivel departamenti sqarojnë më tej masat e marra dhe mënyrën se si janë adresuar mangësitë e identifikuar, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet e vlerësimit gjithashtu dokumentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë zbatimin e masave të ndërmarra për të adresuar mangësitë e konstatuara, me qëllim forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>E. 30.5 Metodologjia e punës së KSHC</i> <i>E. 8 Dokumenti F VII, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 38 Analiza e departamenti përgjegjës për arritjen e objektivave</i>
Kriteri 3. Institucioni, në	Cilësia e programit të studimit vlerësohet në UET përmes

kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	metodave të drejtpërdrejta, duke përfshirë elemente si mësimdhënia, didaktika, kurrikula, provimet dhe detyrat e studentëve. Për vlerësimin e cilësisë së programeve, UET përdor analiza të treguesve të matshëm, përfshirë notat mesatare në hyrje dhe dalje, kalueshmërinë sipas lëndëve/moduleve, vlerësimin e punës së pedagogëve gjatë semestrit, monitorimet e orëve të mësimdhënies, rishikime vjetore të syllabuseve, përfshirjen e praktikave ndërkombëtare më të mira, angazhimin e stafit akademik në projekte, si dhe analizën e infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor. Veprimtaria monitoruese e KSBC është e strukturuar në katër fusha kryesore: <i>A. Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi</i> – monitorimi i orëve dhe procesit mësimor, marrja e opinionit të studentëve dhe përdorimi i sistemit LMS nga KSBC. <i>B. Kërkimi shkencor</i> – ngritja e grupeve AD-Hoc për kërkimin dhe metodologjinë e personelit akademik, krijimi i grupeve kërkimore dhe aktiviteti individual i stafit akademik. <i>C. Mbështetja e studentëve</i> – monitorimi i hyrjeve dhe daljeve të studentëve, lidhja e marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione dhe subjekte, si dhe vlerësimi i punësimit të të diplomuarve. <i>D. Sigurimi i cilësisë</i> – trajnimi për standardet e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë, rishikimi i rregulloreve dhe programeve, analiza SWOT, vlerësimi i burimeve njerëzore dhe ambientit, zhvillimi i testeve dhe detyrave, përgatitja e syllabuseve. Si pjesë e procesit të vlerësimit të performancës, është implementuar edhe <i>Follow Up</i>, që monitoron mësimdhënien dhe aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve nga drejtuesit e institucionit. <i>E. 52. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese. Procedura për ndryshimin e kurrikulës</i> <i>E. 30.8 Formulari i vlerësimit të pefagogut nga eprori-kolegu</i> <i>E. 30.1 Plani i veprimit KSBC</i> <i>E. 29. Tabelat përmbledhëse për punësim real të studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni),	Për të vlerësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, institucioni përdor metoda dhe instrumente të tërthorta. Në këtë kuadër, përfshihen fokus-grupet, pyetësorët online në UET LMS, si dhe mbledhjet e bordit me të diplomuarit (alumni), të cilat synojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe përfshirjen e ish-studentëve në aktivitete me UET. Gjithashtu, për të vlerësuar dijet dhe kompetencat që transmeton programi, përdoren edhe aktivitete të tjera të rëndësishme, si Panairi i Përvitshëm i Punës, mbledhjet me personelin akademik dhe ndihmës-akademik, si dhe vizitat monitoruese nga drejtuesit i

të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Departamentit dhe përgjegjësit e grup-lëndëve. <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i ekspertëve të jashtëm vlerëson se përgatitja dhe shpërndarja e raporteve periodike të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të studimit në UET realizohet përmes një sistemi të mirëstrukturuar dhe funksional, i cili përfshin analiza të detajuara dhe masa për përmirësimin e cilësisë. KSBC ka një rol kyç në koordinimin dhe mbikëqyrjen e këtyre proceseve, ndërsa përdorimi i metodave të ndryshme të vlerësimit dhe përfshirja e komunitetit akademik dhe profesional kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të ofruar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të përbëra nga përfaqësues të hierarkisë institucionale dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përcaktojnë politika dhe procedura të brendshme për përmirësimin e vazhdueshëm dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë realizohet në përputhje me objektivat strategjikë, vizionin dhe misionin e institucionit, si dhe kuadrin rregullator të UET. Parimet, detyrat dhe aktivitetet e sigurimit të cilësisë mbështeten në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë,

vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	standardet europiane dhe ato kombëtare për sigurimin e cilësisë. Në këtë kuadër rregullator dhe udhëzues përcaktohen qartë funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi i zyrave përbërëse, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces përmes strukturave vendimmarrëse dhe shprehjes së mendimeve të tyre, duke përdorur forma të ndryshme të vlerësimit, si pyetësorë dhe fokus-grupe. <i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, UET përcakton detyra dhe përgjegjësi konkrete dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të tyre. Metodologjinë dhe praktikën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka përmirësuar përmes pjesëmarrjes në trajnim, vizita studimore dhe ëorkshop-e të organizuara brenda projekteve ndërkombëtare, duke siguruar zbatimin efektiv të detyrave të përcaktuara. Organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i përshkruan duke përfshirë parimet, qëllimet, objektivat, strukturat përbërëse, detyrat, përgjegjësitë, trajnimet, si dhe angazhimin e studentëve dhe palëve të tjera. Bashkëpunimi i Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KShC) me Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe me Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, realizohet përmes trajnimit të stafit, monitorimit të aktiviteteve për zbatimin dhe vlerësimin e syllabuseve, si dhe për plotësimin e planit mësimor dhe të punës kërkimore. <i>E. 14.2 Plani mësimor i programit shqip</i> <i>E. 14.4 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtareve formuese</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e	Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, si dhe studentëve të programit të studimit, garanton vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit. Departamenti dhe personeli akademik i programit të Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale kontribuojnë vazhdimisht me analiza dhe sugjerime në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe përditësohen rregullisht me informacionin përkatës.

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	<i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit, institucioni garanton respektimin e integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren. Parimet e etikës akademike dhe publike, të detyrueshme për të gjithë, janë të përcaktuara në Kodin e Etikës së UET, duke u përputhur me misionin dhe vizionin e institucionit në mjediset universitare. <i>E. 56. Kodi i Etikës.</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit përfshihen aktivisht në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke dhënë mendim dhe ekspertizë për cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Aktivitete të tilla si Panairi i Punës, leksionet e hapura me personalitete të fushës, si dhe marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione arsimore publike dhe private, vendase dhe të huaja, me institucione të shoqërisë civile, biznese, partnerë dhe donatorë, janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UET. <i>E. 12.2 Poster Panairi i punës</i> <i>E. 34. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	<i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ka krijuar një sistem funksional dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë politika, procedura dhe detyra të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare e europiane. Aktivisht përfshihen studentët, stafi akademik dhe ekspertët e jashtëm, ndërsa angazhimi në trajnime dhe bashkëpunime ndërkombëtare siguron transparencë, paanshmëri dhe kultivon një kulturë të fortë të cilësisë dhe integritetit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Kuadri rregullator i UET parashikon publikimin e veprimtarive, përfshirë ato të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, në faqen zyrtare të UET. Publikimet në faqen zyrtare respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek strukturat përkatëse përmes shkresave zyrtare, në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën UET LMS. http://eut.edu.al/rreth-uet/ <i>E. 56. Kodi i Etikës.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen zyrtare, UET publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit (RVB), duke respektuar lirinë akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të mësuar ose vënë në dispozicion, të konsideruar konfidencial. <i>E. 56. Kodi i Etikës.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit të KSBC shoqërohen me plan masash, i cili synon adresimin e mangësive dhe reduktimin ose eliminimin e dobësive të evidentuara, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë që nga njësia bazë. Mbledhjet e departamentit me personelin akademik zhvillohen periodikisht, çdo javë, ku analizohen dhe diskutohen në detaje ecuria dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjerohen masa për ndërhyrje në përputhje me gjetjet dhe nevojat. Më pas, në nivel njësie bazë dhe kryesore, bazuar në propozimet e bëra, hartohet plani i masave në nivel universiteti. Ky plan miratohet nga Senati Akademik dhe zbatohet në vitin pasues. <i>E. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, Veprimtaria, Monitorimi, Vlerësimi dhe Përmirësimi.</i>

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë e vlerëson institucioni, duke siguruar përmirësimin në vijim të programit të studimit “Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale”. Përditësimet vjetore të programeve të lëndëve (syllabuset), si dhe pasurimin e kurrikulave përmes përfitimeve nga pjesëmarrja e personelit në projekte ndërkombëtare dhe aktivitetet individuale kërkimore-shkencore të stafit akademik sipas fushave të ekspertizës, përbëjnë pjesë të këtij përmirësimi. Për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit angazhohet personeli akademik në mënyrë aktive dhe me përkushtim.			
	<i>E. 43.2 Të dhëna për kërkimin shkencor të programit.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale, institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët. Me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, veprimtaritë periodike përfshijnë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, publikimet në faqen zyrtare të UET dhe platformën UET LMS, si dhe publikime në rrjetet sociale. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për të garantuar transparencën dhe ndërgjegjësimin e tyre në proceset e sigurimit dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Master Profesional në Komunikim dhe Media Digjitale. Veprimtaritë periodike, duke përfshirë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, publikimet në faqen zyrtare të UET dhe platformën UET LMS, si dhe publikimet në rrjetet sociale, synojnë të forcojnë përfshirjen aktive, ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe stafit akademik në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.			
	<i>E. 33 Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron transparencë të plotë dhe akses publik në politikat dhe aktivitetet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke respektuar legjislacionin dhe etikën akademike, përmirëson vazhdimisht cilësinë e programit përmes planeve konkrete të masave, diskutimeve të rregullta dhe veprimtarive periodike me personelin dhe studentët. Për informim dhe përfshirje aktive, institucionit përdor gjithashtu platforma digjitale dhe rrjete sociale, duke e bërë procesin të hapur dhe të qasshëm për të gjithë aktorët e përfshirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Komunikim dhe Media Digjitale” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pika të forta:

- Programi ka një strukturë të qartë akademike me rezultate të nxënies të përcaktuara mirë dhe të përputhura me kompetencat profesionale dhe shkencore.
- Mësimdhënia dhe mësimnxënia bazohen në zhvillimin e kompetencave, duke përfshirë aktivitete praktike dhe integrimin e njohurive të avancuara shkencore.
- Proceset e vlerësimit të studentëve janë transparente, të vazhdueshme dhe mbështeten në rregullore dhe mekanizma efektivë të sigurisë së cilësisë.
- Bashkëpunimet me institucione dhe organizata të ndryshme ofrojnë mundësi të shumta për praktikë dhe zhvillim profesional për studentët.
- Programi nxit mobilitetin dhe ndërkombëtarizimin përmes ofrimit të lëndëve në gjuhën angleze dhe pjesëmarrjes në programet Erasmus.
- Programi organizohet dhe administrohet në përputhje me politikat institucionale dhe siguron mbështetje të duhur administrative.
- Metodat e vlerësimit janë të larmishme, transparente dhe u japin mundësi studentëve të demonstrojnë kompetencat e fituara.

Pika të dobta:

- Gjatë vlerësimit nuk janë evidentuar dobësi specifike

Rekomandime:

- Duke marrë parasysh situatën aktuale të stafit akademik në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, rekomandohet një fokus më i madh në avancimin profesional dhe shkencor të stafit, duke inkurajuar fitimin e gradave të larta akademike. Për më tepër, duke qenë se Shkencat e Komunikimit përbëjnë një fushë ndërdisiplinore, por me kërkesa specifike, është e nevojshme që departamenti të angazhojë më shumë personel akademik me specializime të drejtpërdrejta në këtë fushë, për të siguruar një mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme të programit të studimit.
- Duke mbajtur në konsideratë veçorinë e strukturës organizative të fakultetit, ku Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale mban njëkohësisht edhe funksionin e Shefit të Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit, rekomandohet që institucioni të sigurojë dhe të dokumentojë qartë ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmave të pavarur për trajtimin e ankesave dhe garantimin e lirisë akademike. Kjo do të forcojë transparencën institucionale dhe do të mbështesë një klimë akademike të drejtë, të hapur dhe të bazuar në parimin e ndarjes së funksioneve, duke ruajtur njëkohësisht efikasitetin e strukturës aktuale organizative.
- Të zhvillohen më tej mekanizmat për marrjen e feedback-ut të vazhdueshëm nga alumni-t për të siguruar përshtatjen e programit me nevojat e tregut dhe zhvillimet shkencore.

- Gjatë procesit të verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, rekomandohet që institucioni të sigurojë respektimin e standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin përkatës. Duhet të garantohen masa teknike dhe organizative që informojnë paraprakisht dhe marrin dakordësinë e personit të përfshirë për verifikimin e të dhënave të tij personale, duke kufizuar aksesin vetëm për personat e autorizuar.

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Master of Science Program in “Communication Sciences”, offered by the Higher Education Institution “European University of Tirana”

Strengths:

- The program has a clear academic structure ëith ëell-defined learning outcomes aligned ëith professional and scientific competencies.
- Teaching and learning are based on competency development, incorporating practical activities and integrating advanced scientific knowledge.
- Student assessment processes are transparent, continuous, and supported by regulations and effective quality assurance mechanisms.
- Collaborations ëith various institutions and organizations provide students ëith multiple opportunities for professional development and practical training.
- The program promotes mobility and internationalization through the offering of courses in English and participation in Erasmus programs.
- The program is organized and managed by institutional policies and ensures adequate administrative support.
- Assessment methods are diverse, transparent, and alloë students to demonstrate their acquired competencies.

ëeaknesses:

- No specific ëeaknesses ëere identified during the evaluation process.

Recommendations:

- Considering the current composition of the academic staff in the Department of Humanities and Communication, it is recommended to emphasize the professional and academic advancement of staff members, encouraging the pursuit of higher academic degrees. Furthermore, given that Communication Sciences is an interdisciplinary field ëith specific academic requirements, the department is encouraged to engage more academic personnel ëith direct specialization in this field, to ensure qualitative and sustainable support for the study program.
- Taking into account the organizational structure of the faculty, ëhere the Dean of the Faculty of Humanities, Education and Liberal Arts simultaneously holds the position of

Head of the Department of Humanities and Communication, it is recommended that the institution ensure and document the existence and functioning of independent mechanisms for handling complaints and guaranteeing academic freedom. This could strengthen institutional transparency and support a fair and open academic climate, while maintaining the current organizational efficiency.

- Mechanisms for obtaining continuous feedback from alumni should be further developed to ensure that the program remains aligned with labor market needs and scientific developments.
- During the verification and review process of academic and administrative staff documentation, it is recommended that the institution ensure compliance with confidentiality and personal data protection standards, following relevant legislation. Technical and organizational measures must be in place to inform individuals in advance and obtain their consent before data verification, limiting access only to authorized personnel.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

